



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i
Trasfera - Ministry of Finance, Labour and Transfers

**RAPORTI VJETOR 2021-2022 I ZBATIMIT TË STRATEGJISË
KOMBËTARE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR PARANDALIMIN
DHE LUFTIMIN E EKONOMISË JO-FORMALE, PASTRIMIN E
PARAVE, FINANCIMIN E TERRORIZMIT DHE KRIMEVE
FINANCIARE
2019-2023**

MINISTRIA E FINANCAVE, PUNËS DHE TRANSFEREVE

Mars 2023, Prishtinë, Kosovë

Lista e shkurtesave

ARBK - Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës

ASK - Agjencia e Statistikave të Kosovës

ATK - Administrata Tatimore e Kosovës

BE - Bashkimi Evropian

BQK - Banka Qendrore e Kosovës

DK - Dogana e Kosovës

DPFTF - Departamenti i Politikave Fiskale dhe Tregjeve Financiare

DPMBNF - Departamenti i Politikave Makroekonomike dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar Financiar

FMN - Fondi Monetar Ndërkombëtar

FT - Financimi i Terrorizmit

MAP - ish-Ministria e Administratës Publike

MD - Ministria e Drejtësisë

MF - ish-Ministria e Financave

MFPT - Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve

MINT - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë

MPMS - ish-Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

MSA - Marrëveshja e Stabilizim Asociimit

NJIF - Njësia e Inteligjencës Financiare

PK - Policia e Kosovës

PP - Pastrimi i Parave

SKZH - Strategjia Kombëtare e Zhvillimit

SLEJ - Strategjia për Luftimin e Ekonomisë Joformale

TVSH - Tatimi mbi Vlerën e Shtuar

Përmbajtja

Lista e shkurtesave	2
1 Përmbledhja ekzekutive	5
1.2 Sfidat kryesore, rreziqet dhe masat e nevojshme korrigjuese.....	7
2 Progresi në zbatimin e objektivave të Strategjisë Kombëtare	8
2.1 Progresi kundrejt objektivit Strategjik I	18
2.2 Progresi kundrejt Objektivit Strategjik II	32
3 Rreziqet dhe hapat e ardhshëm	38
3.1 Problemet dhe rreziqet.....	38
3.2 Hapat e ardhshëm	38
Shtojca 1	40
Organogrami i mekanizmave mbikëqyrës dhe zbatues i Strategjisë Kombëtare.....	40

Lista e Grafikëve

Grafiku 1. Progresi në zbatimin e aktiviteteve të SLEJ për periudhën 2021-2022	8
Grafiku 2. Zbatimi i aktiviteteve në kuadër të Objektivit Strategjik I	18
Grafiku 3. Zbatimi i aktiviteteve në kuadër të Objektivit Strategjik II	33
Grafiku 4. Organogrami i mekanizmave mbikëqyrës dhe zbatues të Strategjisë Kombëtare	39

Lista e Tabelave

Tabela 1. Zbatimi i aktiviteteve të SLEJ 2019-2023 për periudhën 2021- 2022.....	9
Tabela 2. Gjetjet për shmangiet tatimore, ndëshkimet dhe interesat për periudhën 2021-2022 (në EUR)..	22
Tabela 3. Të hyrat e Doganës së Kosovës nga aktivitetet e luftimit të ekonomisë joformale për periudhën 2021-2022 (në EUR)	23
Tabela 4. Numri i transaksioneve në POS terminale në tri vitet e fundit.....	23
Tabela 5. Numri i bizneseve të fiskalizuara gjatë periudhës 2021-2022.....	24
Tabela 6. Numri i vizitave në biznese për pajisjen me arkë fiskale, numri dhe vlera e gjobave për periudhën 2021-2022	24
Tabela 7. Aktivitetet lidhur me veprat penale të krimeve ekonomike, shpërlarjes së parasë, krimit të organizuar dhe korrupsionit në kuadër të Prokurorisë së Shtetit për periudhën 2021-2022	26
Tabela 8. Aktivitetet hetimore doganore për veprat penale kundër ekonomisë.....	27
Tabela 9. Kundërvajtjet doganore, vlera e mallit në kundërvajtje dhe e gjobave të shqiptuara për periudhën 2021-2022	27
Tabela 10. Trajtimi dhe hetimi i rasteve për shmangien tatimore për periudhën 2021-2022.....	27
Tabela 11. Numri i kontrolleve dhe vlera e shmangies tatimore në euro për periudhën 2021-2022 (EUR).	28

Tabela 12. Pasqyrë sistematike e të dhënave lidhur me vizitat dhe aktivitetet për periudhën 2021-2022 sipas Drejtorive Rajonale (EUR).....	28
Tabela 13. Aktivitetet të ndërmarra për parandalimin e mallrave që shkelin të drejtën e pronësisë intelektuale.....	36
Tabela 14. Statistika për numrin e patrullimeve të njësiteve anti kontrabandë.....	36
Tabela 15. Trajnimet e prokurorëve për veprat penale kundër ekonomisë dhe pastrimit të parasë.....	37

1 Përmbledhja ekzekutive

Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2019-2023 (tani e tutje SLEJ 2019-2023) ka për qëllim zhvillimin e një sistemi të qëndrueshëm në Kosovë për të luftuar ekonominë joformale, financimin e terrorizmit dhe krimet tjera financiare për tu integruar në luftën rajonale dhe ndërkombëtare për të siguruar paqe sociale, mirëqenie, dinjitet, barazi dhe zhvillim të qëndrueshëm ekonomik në përputhje me politikat e Qeverisë së Republikës së Kosovës (tani e tutje QRK).

Strategjia Kombëtare përmban dy objektiva strategjike, shtatë objektiva specifike si dhe 71 aktivitete.

Objektivat strategjike që synohen të arrihen nëpërmjet kësaj Strategjie janë:

- Përmirësimi i cilësisë së qeverisjes në ekonomi nëpërmjet identifikimit, analizimit, trajtimit dhe monitorimit të luftimit të ekonomisë joformale, pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit
- Rritja e burimeve financiare për shërbimet publike si rezultat i të hyrave shtesë tatimore dhe nga konfiskimi i pasurisë së paligjshme.

Këto dy objektiva janë shprehje e përmirësimit sasior dhe cilësor të cilat Qeveria i mendon si themeltare për t'u përballur me sfidat dhe problemet e ekonomisë joformale. Po ashtu ato janë edhe një jetësim i angazhimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës në dialogun me Bashkimin Evropian (BE) gjatë vitit 2018, përputhshmëri me dokumentin themeltar Strategjia Kombëtare e Zhvillimit (SKZH) dhe Programin e Reformave Ekonomike 2019-2021 si dhe dokumente të tjera strategjike të Kosovës.

Ky dokument paraqet Raportin Vjetor të zbatimit të Strategjisë Kombëtare i cili përfshin periudhën 2021-2022. Raporti është bazuar në Planin e Veprimit dhe raporton për përmbushjen e aktiviteteve në kuadër të objektivave strategjike dhe specifike. Megjithatë, ky dokument nuk përmban progresin mbi indikatorët, pasi që Strategjia do të ketë raportin e plotë pesëvjeçar të zbatimit të saj i cili do të përmbajë informata lidhur me zbatimin e tyre. Raporti është përgatitur në bashkëpunim të ngushtë me institucionet përgjegjëse në harmoni me Udhëzimin Administrativ (QRK) nr.07/2018 dhe ndjek procedurat dhe praktikën e rregullta të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT).

Gjatë periudhës raportuese mund të themi se është arritur të përmbushet pjesërisht ajo çfarë është synuar, ku nga gjithsej shtatëdhjetë e një (71) aktivitete, dyzet e katër (44) apo 62% prej tyre janë zbatuar, ndërsa njëzet e shtatë (27) apo 38% e tyre nuk janë zbatuar ende.

Objektivi Strategjik I përmban në vete katër (4) objektiva specifike dhe gjithsej pesëdhjetë e tre (53) aktivitete, ku tridhjetë e dy (32) apo 60% prej tyre janë zbatuar, kurse njëzet e një (21) apo 40% prej tyre nuk janë zbatuar ende. Në kuadër të këtij Objektivit progres është shënuar në përmirësimin cilësor të të dhënave për të mundësuar zhvillimin e politikave që në mënyrë të efektshme kontribuojnë në uljen e ekonomisë joformale. Përkatësisht, ka vazhduar përdorimi i të dhënave të anketave statistikore nga ASK në parashikimet makro-fiskale të MFPT-së; progres është shënuar edhe në përpilimin e të dhënave të ekonomisë joformale në harmoni të plotë me metodologjinë dhe standardet ndërkombëtare, ku për herë të parë ASK ka integruar të dhënat e ekonomisë joformale në të dhënat e BPV dhe është rritur mbikëqyrja

nga Banka Qendrore e Kosovës për përshkrimin e transaksioneve financiare nga bankat në mënyrë që të rritet dobia e informacionit.

Po ashtu, gjatë periudhës raportuese institucionet kanë vazhduar me ngritjen e aktiviteteve të komunikimit me publikun dhe rritjen e numrit të konferencave, punëtorive, takimeve të përbashkëta me shoqatat profesionale për të diskutuar ndikimin e masave të luftës kundër ekonomisë joformale, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare; është shtuar numri i aktiviteteve hetimore për veprat penale kundër ekonomisë siç është e përcaktuar në Kodin Penal të Kosovës (Kapitulli XXV); është rritur numri i bizneseve të pajisura me arka fiskale, numri i vizitave dhe kontrolleve të realizuara bazuar në vlerësimin e rrezikut në luftimin e ekonomisë joformale dhe shmangies tatimore. Progres është shënuar edhe në përmirësimin cilësor të kapaciteteve institucionale dhe bashkërendimit për zbatim më të mirë të politikave të miratuara, duke intensifikuar aktivitetet në mes ATK dhe ish-Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (ish-MPMS), duke rritur numrin e veprimeve të koordinuara (kontroll/inspektim) të NJJF dhe organeve të zbatimit të ligjit në bizneset me rrezik të lartë dhe duke siguruar bashkëpunim funksional nga Administrata Tatimore e Kosovës dhe Dogana e Kosovës me Administratat e huaja tatimore dhe doganore. Në kuadër të këtij Objektivit performancë e mirë u arrit edhe në zvogëlimin e punësimit joformal në vend, përmes organizimit të fushatave informuese për publikun dhe punëdhënësit; analizës së gjendjes dhe vlerësimit të praktikave të mira për zvogëlimin e punës joformale; zhvillimit të manualit/procedurave të veprimit për inspektim; trajnimeve për ngritjen e kapaciteteve të inspektorëve dhe pajisjen e inspektorëve me mjete pune.

Ndërsa, aktivitetet në të cilat ka pasur ngecje gjatë periudhës raportuese janë: realizimi i Anketës për çmimet e tokës bujqësore, publikimi i vazhdueshëm i të dhënave të fushës së financave publike sipas formatit të të dhënave të hapura në Portalin Kombëtar për të Dhëna të Hapura, zhvillimi dhe prezantimi i moduleve të reja të programeve fiskale për të përmirësuar parashikimet fiskale për të ardhurat në sektorë dhe pajisja e inspektorëve me vetura; implementimi i faturës elektronike në sistemin e ri të TI-së në ATK.

Sa i përket Objektivit Strategjik II mund të konsiderojmë se është përmbushur në pjesën më të madhe të tij. Ky objektivi përmban në vete tre (3) objektiva specifike dhe gjithsej tetëmbëdhjetë (18) aktivitete, dymbëdhjetë (12) apo 67% prej të cilave janë zbatuar, kurse gjashtë (6) apo 33% e tyre nuk janë zbatuar.

Progres i konsiderueshëm në kuadër të këtij objektivit strategjik u shënuar në përmirësimin sasior të kapaciteteve institucionale dhe bashkërendimit për zbatim më të mirë të politikave të miratuara. Përkatesisht, pati zhvillime në zgjerimin e inspektimeve në sektorin e ndërtimit dhe OJQ-ve lidhur me FT (Financimi i Terrorizmit) dhe PP (Pastrimi i Parave); u krijuan grupe të përbashkëta në mes të DK dhe ATK me qëllim kontrollin e mallrave që kategorizohen me rrezik të lartë të shmangies së taksave. Përfundimisht e mirë u realizua edhe në hetimin dhe realizimin e operacioneve të përbashkëta me qëllim luftimin e kontrabandës së mallrave; u rrit numri i aktiviteteve të ndërmarra në parandalimin e mallrave që shkelin të drejtën e pronësisë Intelektuale – IPR dhe numri i patrullimeve të njësiteve anti kontrabandë me qëllim luftimin e kontrabandës; po ashtu u bë edhe aplikimi i kontrolleve pas importuese në bazë të menaxhimit të rrezikut dhe informacioneve tjera. Gjithashtu, gjatë periudhës raportuese u realizuan edhe

trajnime për ATK-në në fushën e menaxhimit të rrezikut, për Doganat e Kosovës në fushën e zbatimit të Ligjit; trajnime të dedikuara profesionalizmi të Prokurorëve për veprën penale të krimit ekonomik dhe pastrimin e parave; trajnime për institucionet që monitorojnë aktivitetet në sektorin e ndërtimtarisë mbi PP/FT, lidhur me parandalimin e ekonomisë joformale dhe krimet tjera financiare, posaçërisht në sektorin e ndërtimtarisë dhe patundshmërive (auditorët dhe inspektorët) dhe trajnime për ngritjen e aftësive profesionale në fushën e PP/FT për Prokurorët, Gjyqtarët, Hetuesit dhe Inteligjencën Financiare.

Ndërsa, aktivitetet në të cilat ka pasur ngecje gjatë periudhës raportuese janë: kryerja e vlerësimeve të impaktit të masave të politikave me objektiv ekonominë joformale, vlerësimi i hendekut tatimor sipas standardeve ndërkombëtare, ulja e pragut lidhur me transaksionet në mes bizneseve të cilat bëhen në kesh, dizajnimi i softuerit për arkat fiskale për të dhënë informata lidhur me numrin e kuponëve fiskal të lëshuar, kohën dhe artikujt në kohë reale (online) dhe përmirësimi i kapaciteteve të parashikimeve fiskale për të ardhurat nëpër sektorë përmes instalimit të moduleve të reja krahas modelit të programimit fiskal.

1.2 Sfidat kryesore, rreziqet dhe masat e nevojshme korrigjuese.

Sfida kryesore në progres të zbatimit të kësaj strategjie gjatë periudhës raportuese ishte kryesisht ndërmarrja e masave për ta luftuar pandeminë, të cilat ndikuan në rrjedhën normale të punës së institucioneve zbatuese dhe raportuese të Strategjisë Kombëtare.


Rreziqet kryesore janë ngecja e progreseve si rezultat i vazhdimit të pengesave nga pandemia në realizimin e aktiviteteve, mungesa e stafit dhe qarkullimi i madh i stafit në departamente kyçe si dhe moskoordinimi në mes të institucioneve zbatuese të Strategjisë Kombëtare. Prandaj, si masa të nevojshme korrigjuese sugjerohet që institucionet përgjegjëse ta rrisin bashkëpunimin ndërinstitucional, duke prioritetizuar aktivitetet e Strategjisë Kombëtare dhe realizimin e tyre sipas afateve të përcaktuara. Përkatësisht institucionet duhet t'i riplanifikojnë afatet e zbatimit të aktiviteteve, ta përgatisin infrastrukturën ligjore për zbatimin e aktiviteteve të Strategjisë Kombëtare, t'i dokumentojnë proceset e punës në departamente me qarkullim të madh të punëtorëve dhe të rrisin kapacitetet e stafit përkatës për zbatimin e aktiviteteve të caktuara në Strategjinë Kombëtare.

2 Progresi në zbatimin e objektivave të Strategjisë Kombëtare

Ky seksion përshkruan progresin e bërë drejt zbatimit të secilit objektiv të Strategjisë Kombëtare. Sa i përket progresit të shënuar në zbatimin e Strategjisë Kombëtare gjatë periudhës 2021-2022, vlen të theksohet se pas përmirësimit të situatës me pandeminë, institucionet përgjegjëse për zbatimin e aktiviteteve të SLEJ 2019-2023 kanë punuar më intenzivisht në zbatim të aktiviteteve për luftimin e ekonomisë joformale, pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe krimet financiare.

Si rezultat i kësaj, siç shihet në Grafikon 1, gjatë periudhës raportuese, nga gjithsej shtatëdhjetë e një (71) aktivitete, dyzet e katër (44) apo 62% prej tyre janë zbatuar, ndërsa njëzet e shtatë (27) apo 38% e tyre nuk janë zbatuar ende.

Grafiku 1. Progresi në zbatimin e aktiviteteve të SLEJ për periudhën 2021-2022



Burimi: Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Jo-Formale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2019-2023

Tabela në vijim pasqyron statusin e zbatimit të aktiviteteve të Strategjisë Kombëtare dhe vazhdon me një përshkrim të shkurtër të progresit për secilin aktivitet.

Tabela 1. Zbatimi i aktiviteteve të SLEJ 2019-2023 për periudhën 2021-2022

Aktiviteti	Afati i fundit	Institucioni udhëheqës dhe mbështetës	Statusi i aktivitetit 2021/2022 (zbatuar/pazbatuar)
OBJEKTIVI STRATEGJIK I: Përmirësimi i cilësisë së qeverisjes në ekonomi nëpërmjet identifikimit, analizimit, trajtimit dhe monitorimit të luftimit të ekonomisë joformale, pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit			
Objektivi specifik 1: Përmirësimi cilësor i të dhënave për të mundësuar zhvillimin e politikave që në mënyrë të efektshme kontribuojnë në uljen e ekonomisë joformale.			
1.1.1 Avancimi në përdorimin e të dhënave të anketave statistikore nga ASK (Agjencia e Statistikave të Kosovës) në modelet e vlerësimit të ekonomisë joformale në Kosovë, në parashikimet makro-fiskale të Ministrisë së Financave (MF) dhe masave politike të adresuara në strategji sektoriale	K1 2020 dhe vazhdueshëm	MF/DPMBNF	Zbatuar
1.1.2 Sigurimi i pajtueshmërisë së të dhënave të ASK lidhur me ekonominë joformale në përputhje me metodologjitë dhe standardet ndërkombëtare	K4 2020 dhe vazhdueshëm	ASK	Zbatuar
1.1.3 Realizimi i anketës për çmimet e tokës bujqësore nga ASK	K4 2021	ASK	Pazbatuar
1.1.4 Përgatitja e një udhëzuesi mbi Metodologjinë e Vlerësimit të impaktit të ndryshimeve tatimore (Tax Expenditure), i cili të zbatohet ose praktikohet përpara miratimit të çdo mase fiskale të propozuar	K2 2019	MF/DPFTF	Zbatuar
1.1.5 Specifikimi në thesar i komponentëve të pagesave nga tatimpaguesit: i) Gjobë, ii) Ndëshkim, iii) Interes, iv) Shmangie tatimore, v) Lloj Tatimi	K4 2019 dhe vazhdueshëm	MF/Thesari i Kosovës; ATK	Pazbatuar
1.1.6 Rritja e mbikëqyrjes nga BQK (Banka Qendrore e Kosovës) për përshkrimin e transaksioneve financiare nga bankat në mënyrë që të rritet dobja e informacionit për analiza cilësore në organet përkatëse	K4 2019 – K4 2022	BQK	Zbatuar

1.1.7 Krijimi i një sistemi ndër bankar të pagesave me qëllim të stimulimit të pagesave me kartelë dhe formave të tjera të pagesave duke zvogëluar në masë përdorimin e kesh-it si mjet pagese	K2 2020 – K4 2022	BQK; Qeveria e Republikës së Kosovës	Pazbatuar
1.1.8 Dhënia e Kredive bankare bazuar në pasqyrat financiare të dorëzuara në ATK dhe të certifikuara nga ekspertët e lëmisë për të gjitha bizneset që janë të obliguara të dorëzojnë pasqyrat në këtë institucion	K4 2019	BQK	Pazbatuar
1.1.9 Publikimi i vazhdueshëm i të dhënave të fushës së financave publike sipas formatit të të dhënave të hapura në Portalin Kombëtar për të Dhëna të Hapura	K2 2020	MAP	Pazbatuar
1.1.10 Zgjerimi i gamës së Vlerësimeve të Rrezikut nga NJIF (Njësia e Inteligjencës Financiare) duke shtuar vlerësimin e Sektorit Financiar	K4 2019	NJIF	Zbatuar
Objektivi Specifik I.2 Rritja cilësore e përmbushjes vullnetare përmes ngritjes së vetëdijes, raportimit dhe masave ligjore të kufizimit			
1.2.1 Rritja e aktiviteteve të komunikimit me publikun (numrin, pjesëmarrësit dhe buxheti) për të rritur shkallën e ndërgjegjësimit të qytetarëve nga organet përgjegjëse për zbatimin e kësaj strategjie	Vazhdueshëm	MF/ ATK; DK; MPMS; PK	Zbatuar
1.2.2 Rritja e numrit të konferencave, punëtorive, takimeve të përbashkëta me shoqatat profesionale për të diskutuar ndikimin e masave të luftës kundër ekonomisë joformale, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare (anëtarësisë së këtyre shoqatave, numri i pjesëmarrësve dhe dokumentet e konferencave)	Vazhdueshëm	MF/ ATK; NJIF; MPMS; DK; PK	Zbatuar
1.2.3 Pasqyrimi në raportin vjetor të zbatimit të strategjisë lidhur me të ardhurat nga ekonomia joformale gri dhe e zezë në faqen e internetit të MF	K4 2019 dhe vazhdueshëm	MF/ ATK; NJIF; MPM; D; PK	Zbatuar
1.2.4 Përgatitja dhe Publikimi i Fletëpalosjes me informacion për publikun rreth efektit të pritur në parandalimin e ekonomisë joformale	K4 2019 dhe vazhdueshëm	BQK	Zbatuar

nga zbatimi i masave të parapara sipas nenit 64 të MSA mbi sistemet e Pagesave			
1.2.5 Të bëhet një studim lidhur me procesin e vlerësimit të çmimit të pronës, regjistrimit të të patundshmeve në rast blerjeje për herë të parë apo transferimi në mënyrë që vlera e asetit të regjistruar të pasqyrojë vlerën aktuale të tregut	K1 2020	Kadastra; MF/ Departamenti i Tatimit mbi Pronën; Komunat; BQK; MD	Pazbatuar
1.2.6 Të funksionalizohet sistemi i unifikuar i adresave	K2 2020 Studimi Në varësi të afateve të parapara në Studim deri në fund të vitit 2022	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor; Agjencioni Kadastral i Kosovës; Komunat.	Pazbatuar
1.2.7 Përgatitja e koncept dokumentit lidhur me dorëzimin e deklaratës vjetore të tatimit mbi të ardhurat personale në ATK edhe nga personat fizik jo afarist	K1 2021	MF/ ATK	Zbatuar
1.2.8 Përgatitja e koncept dokumentit lidhur me dorëzimin e deklaratës vjetore familjare të tatimit mbi të ardhurat personale në ATK edhe nga personat fizik jo afarist	K1 2021	MF/ ATK	Pazbatuar
1.2.9 Të gjitha pagesat e të punësuarve nga ana e punëdhënësit të bëhen nëpërmjet sistemit bankar	K4 2019	MPMS; MF/ATK	Pazbatuar
1.2.10 Rritja e numrit të bizneseve të pajisura me arka fiskale	Në vazhdimësi	MF/ ATK	Zbatuar
1.2.11 Të implementohet fatura elektronike në sistemin e ri të TI-së në ATK	K2 2020	MF/ ATK	Pazbatuar
1.2.12 Plotësim/ndryshimi i Ligjit për Financimin e Partive Politike dhe nxjerrja e akteve ligjore dhe nënligjore për publikimin dhe transparencën e informacionit të financave të partive politike	K4 2019	KQZ/ ZKM	Zbatuar

1.2.13 Auditimi i pavarur i financave të partive politike dhe publikimi i rezultateve të tyre	K4 2020	Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA)	Pazbatuar
1.2.14 Themelimi i njësisë për Rikthimin e Aseteve të Konfiskuara	Deri në fund të vitit K2 2020 AT dhe deri në fund të vitit 2022 vënia në funksionim të plotë e Agjencisë	AMSKA	Zbatuar
1.2.15 Krijimi i fondit të konfiskimit në Kosovë	K2 2020	MD	Pazbatuar
1.2.16 Fillimi i hetimit financiar që në fillim në raste kur dyshohet për korrupsion e për të cilat PK dhe Prokuroria e Shtetit vlerëson se ka potencial për konfiskim të pasurisë të fituar me veprën penale në përputhje me rekomandimet e FATF-së	K4 2019	PK; Prokuroria e Shtetit	Zbatuar
1.2.17 Shtimi i aktiviteteve hetimore për veprat penale kundër ekonomisë siç është e përcaktuar në Kodin Penal të Kosovës (Kapitulli XXV)	Vazhdueshëm duke filluar që prej K4 2019	PK/Prokuroria e Shtetit; DK dhe ATK	Zbatuar
1.2.18 Aprovimi i Koncept dokumentit për përmirësimin e legjislacionit në fushën e Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Luftimit të Financimit të Terrorizmit, në përputhje me praktikën e BE-së, rekomandimet e PECK II, Raportit të Vendit 2018 për Kosovën dhe MSA (Neni 89)	K4 2019	MF/NJIF	Pazbatuar
1.2.19 Rritja e numrit të vizitave dhe kontrolleve të realizuara bazuar në vlerësimin e rrezikut në luftimin e ekonomisë joformale dhe shmangies tatimore	K3 2019 Vazhdueshëm deri në fund të 2022	ATK	Zbatuar
1.2.20 Plotësim ndryshimi i Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat	K3 2019	MF/ ATK	Pazbatuar
Objektivi Specifik I.3: Përmirësimi cilësor i kapaciteteve institucionale dhe bashkërendimit për zbatim më të mirë të politikave të miratuara.			
1.3.1 Përditësimi i vazhdueshëm i klasifikimit të aktivitetit ekonomik të bizneseve sipas nomenklaturës ndërkombëtare (NACE rev.2) dhe	K2 2019 dhe vazhdueshëm	ARBK/ ATK; ASK	Zbatuar

shkëmbimi i këtyre informacioneve në mes të ARKBK-së, ATK-së dhe ASK-së			
1.3.2 Intensifikimi dhe bashkërendimi i aktiviteteve në mes ATK dhe Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) me qëllim identifikimin dhe regjistrimin e punëtorëve të pa regjistruar, duke u bazuar në të dhënat e marra nga Agjencia e Statistikave të Kosovës në publikimin e anketave të ekonomisë joformale	K1 2020 Vazhdueshëm	MPMS; ATK	Zbatuar
1.3.3 Arritja e një memorandumit të mirëkuptimit midis Ministrisë së Drejtësisë dhe MF/ATK për të siguruar shkëmbimin e të dhënave nga noterët për transaksionet i) Në patundshmëri ii) Makina iii) Qira, i cili si minimum të ofrojë informacion mbi numrin e transaksioneve, tipin (blerje, transferim, qira), adresën, vlerën, subjektin (person fizik, biznes apo publik)	K1 2020	MD; MF/ATK	Pazbatuar
1.3.4 Zhvillimi dhe prezantimi i moduleve të reja të programeve fiskale për të përmirësuar parashikimet fiskale për të ardhurat në sektorë	K1 2020	MF	Pazbatuar
1.3.5 Publikimi dhe përditësimi i listës së High Risk Countries (sipas publikimeve të FATF), Lista e Zezë EU, OECD Lista e Gold Passports 2018 etj.	Vazhdueshëm	NJIF	Zbatuar
1.3.6 Rishikimi i metodologjisë së vlerësimit të Rrezikut NJIF sipas rekomandimeve të vlerësimeve dhe asistencës teknike në këtë fushë	K4 2019	NJIF	Zbatuar
1.3.7 Rritja e veprimeve të koordinuara (kontroll/inspektim) të NJIF dhe organeve të zbatimit të ligjit në bizneset me rrezik të lartë, pjesë e listës së identifikuar nga NJIF	K2 2019 dhe vazhdueshëm	NJIF; PK; ATK; DK	Zbatuar
1.3.8 Rritja e inspektimeve dhe aktiviteteve të mbikëqyrjes së pajtueshmërisë në zyrat noteriale dhe agjencitë e paluajtshmërive, për të vlerësuar pajtueshmërinë e subjekteve raportuese me Ligjin për PPP dhe FT	K4 2019-2022	NJIF	Zbatuar
1.3.9 Të sigurohet bashkëpunimi funksional nga Administrata Tatimore dhe Dogana e Kosovës me Administratat e huaja tatimore dhe Doganore përmes nënshkrimit të MM-ve, për forcimin e shkëmbimeve ndërkombëtare të informacionit e veçanërisht lidhur me kompaninë amë apo kompaninë e linjës	K4 2019-2022	MF/ATK; DK	Zbatuar

1.3.10 Të rritet cilësia e monitorimit dhe procedurave penale të ndërtimeve për të zvogëluar ndërtimin e kundërligjshëm dhe ndërtimin e ndërtesave që nuk i përmbushin specifikacionet e kërkuara	K2 2020-2022	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH); MF/Departament i i Tatimit ne Prone; Komunat	Zbatuar
1.3.11 Trajnimi dhe rritja e kapaciteteve në Divizionin e Ekonomisë joformale dhe llogarive qeveritare	K4 2019 dhe vazhdueshëm	ASK	Zbatuar
1.3.12 Trajnimi për “Forecast consolidation” të Divizionit të Politikave Fiskale për “Tax Expenditures and Impact Assessment”	K4 2019- 2022	MF	Pazbatuar
Objektivi Specifik I. 4: Zvogëlimi i punësimit joformal në Kosovë			
1.4.1 Organizimi i fushatave informuese për publikun dhe punëdhënësit	T4 2019, 2020 dhe 2021	MPMS; ATK, MTI; MF; Partnerët social	Zbatuar
1.4.2 Angazhimi i palëve të interesit dhe publikut të gjerë në adresimin e punësimit joformal	T3 2019, 2020 dhe 2021	MPMS, MF, MTI, ATK, TRUSTI, KES	Zbatuar
1.4.3 Analiza e gjendjes dhe vlerësimi i praktikave të mira për zvogëlimin e punës joformale.	T4 2019	MPMS; Ministrinë e linjës partnerët social	Zbatuar
1.4.4 Realizimi i një analize lidhur me krijimin e regjistrat të të punësuarve në kuadër të MPMS	T3 2020	MPMS, ATK, APRK, Trusti	Zbatuar
1.4.5 Përgatitja e udhëzuesit për metodologjinë e vlerësimit të shkallës së rrezikshmërisë së rasteve/prioritizimi dhe vendosja e planit të inspektimit dhe trajnimit të stafit përkatës për përdorimin e metodologjisë	T1 2020	MPMS, ATK	Pazbatuar
1.4.6 Zhvillimi i manualit/procedurat e veprimit për inspektimin	T4 2019	MPMS, ATK	Zbatuar

1.4.7 Ndërtimi i një sistemi monitorues dhe sistemi për vlerësimin e performancës sëpunës së inspektorëve	Nuk ka kosto shtesë. Kosto e përfshirë në Planin e Veprimit të Strategjisë Sektoriale, Aktiviteti 3 në kuadër të Objektivës Specifike 2.2	MPMS, ATK	Pazbatuar
1.4.8 Trajnime për ngritjen e kapaciteteve të inspektorëve	T4 2019	MPMS	Zbatuar
1.4.9 Funkcionalizimi/ndërtimi i Sistemit të Menaxhimit të Informatave	T4 2019	MPMS	Pazbatuar
1.4.10 Pajisja e inspektorëve me mjete pune	T4 2019	MPMS	Zbatuar
1.4.11 Pajisja e inspektorëve me vetura	T4 2019, 2020 dhe 2021	MPMS	Pazbatuar
OBJEKTIVI STRATEGJIK II: Rritja e burimeve financiare për shërbimet publike si rezultat i të hyrave shtesë tatimore dhe nga konfiskimi i pasurisë së paligjshme.			
Objektivi specifik II.1: Përmirësimi sasior i të dhënave për të mundësuar zhvillimin e politikave që në mënyrë të efektshme kontribuojnë në uljen e ekonomisë joformale.			
2.1.1 Kryerja e vlerësimeve të impaktit të masave të politikave të publikuara nga administrata e Kosovës me objektiv ekonominë joformale (Impact Assessments)	K4 2019 - 2022	MF	Pazbatuar
2.1.2 Kryerja e studimeve apo vlerësimeve në fushën e ekonomisë joformale sipas standardeve ndërkombëtare lidhur me hendekun tatimor	K4 2019 - 2022	MF; ATK; MPMS; ASK	Pazbatuar
Objektivi Specifik II.2: Rritja sasiore e përmbushjes vullnetare përmes ngritjes së vetëdijes, raportimit dhe masave ligjore të kufizimit.			
2.2.1 Ulja e pragut lidhur me transaksionet në mes bizneseve të cilat bëhen në kesh (aktualisht 500 EUR)	K1 2020	MF/ATK	Pazbatuar

2.2.2 Dizajnimi i Softuerit për arkat fiskale për të dhënë informata lidhur me numrin e kuponëve fiskal të lëshuar, kohën dhe artikujt në kohë reale (online)	K2 2020	ATK	Zbatuar
Objektivi Specifik II.3: Përmirësimi sasior i kapaciteteve institucionale dhe bashkërendimit për zbatim më të mirë të politikave të miratuara.			
2.3.1 Rishikimi i formave standarde për shkëmbim të dhënave elektronike dhe në bartës fizik me qëllim shkurtimin e kohës së rrjedhës së informacionit në komunikimin ndërinstytucional dhe ndërkombëtar	K4 2019	MAP/MD; PK; ATK; DK; NJIF	Pazbatuar
2.3.2 Publikimi i Tabelës Ofruese/Përdoruese nga ASK	K2 2020	ASK	Pazbatuar
2.3.3 Përmirësimi i kapaciteteve të parashikimeve fiskale për të ardhurat nëpër sektorë përmes instalimit të moduleve të reja krahas modelit të programimit fiskal	K4 2020	MF	Pazbatuar
2.3.4 Zgjerimi i inspektimeve në sektorin e ndërtimitarisë dhe OJQ-ve lidhur me FT (Financimi i Terrorizmit) dhe PP (Pastrimi i Parave), ku inspektimet tek subjektet e caktuara që paraqesin rrezik më të lartë, të bazohen në inteligjencën financiare, tatimore dhe kriminale (Target të jetë sektori i ndërtimitarisë)	K4 2019- 2022	NJIF/ ATK, PK	Zbatuar
2.3.5 Krijimi i grupeve të përbashkëta në mes të DK dhe ATK me qëllim kontrollin e mallrave që kategorizohen me rrezik të lartë të shmangiesë taksave	K4 2019- 2022	DK; ATK	Zbatuar
2.3.6 Hetimi dhe realizimi i operacioneve të përbashkëta me qëllim luftimin e kontrabandës së mallrave	K4 2019- 2022	PK; DK; Prokuroria	Zbatuar
2.3.7 Rritja e aktiviteteve të ndërmarra në parandalimin e mallrave që shkelin të drejtë pronësisë Intelektuale – IPR	K4 2019- 2022	DK	Zbatuar
2.3.8 Rritja e numrit të patrullimeve të njësiteve anti kontrabandë me qëllim luftimin e kontrabandës	K4 2019- 2022	DK	Zbatuar
2.3.9 Aplikimi i kontrolleve pas importuese në bazë të menaxhimit të rrezikut dhe informacioneve tjera	K4 2019- 2022	DK	Zbatuar


2.3.10 Trajnime për ATK-në në fushën e menaxhimit të rrezikut	K4 2019- 2022	ATK	Zbatuar
2.3.11 Trajnim për Doganat e Kosovës në fushën ezbatimit të Ligjit	K4 2019- 2022	DK	Zbatuar
2.3.12 Trajnime të dedikuara profesionalizmi të Prokurorëve për veprën penale të krimit ekonomik dhe pastrimin e parave	K4 2019- 2022	Prokuroria	Zbatuar
2.3.13 Organizimi i trajnimeve për institucionet që monitorojnë aktivitetet në sektorin e ndërtimit mbi PP/FT, lidhur me parandalimin e ekonomisë joformale dhe krimet tjera financiare, posaçërisht në sektorin e ndërtimit dhe patundshmërive (auditorët dhe inspektorët)	K4 2019- 2022	NJIF	Zbatuar
2.3.14 Ngritja e aftësive profesionale në fushën e PP/FT për Prokurorët, Gjyqtarët, Hetuesit dhe Inteligjenca Financiare	K4 2019 - 2022	NJIF/ PK; MD; Prokuroria	Zbatuar

2.1 Progresi kundrejt objektivit Strategjik I

Ky objektivi synon përmirësimin e cilësisë së qeverisjes në ekonomi nëpërmjet identifikimit, analizimit, trajtimit dhe monitorimit të luftimit të ekonomisë joformale, pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Përmes aktiviteteve të këtij objektivit synohet të bëhet korrigjimi i problemit të dëmtimit të cilësisë së qeverisjes ekonomike për shkak të ekonomisë joformale të shprehur si prani e konkurrencës së padrejtë, pabarazi, moszbatim i kontratave, prani e artikujve të kontrabandës dhe punësim joformal me të drejta të pakta të të punësuarve.

Në kuadër të këtij objektivit janë gjithsej pesëdhjetë e tre (53) aktivitete, të ndara në katër (4) objektiva specifikë, nga të cilat tridhjetë e dy (32) apo 60% prej tyre janë zbatuar, kurse njëzet e një (21) apo 40% prej tyre nuk janë zbatuar.

Grafiku 2. Zbatimi i aktiviteteve në kuadër të Objektivit Strategjik I për periudhën 2021-2022



Burimi: Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Jo-Formale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2019-2023

Në **Objektivin specifik 1.1** është synuar përmirësimi cilësor i të dhënave për të mundësuar zhvillimin e politikave që në mënyrë të efektshme kontribuojnë në uljen e ekonomisë joformale.

Ky objektivi përmban gjithsej dhjetë (10) aktivitete, pesë (5) apo 50% prej të cilave janë zbatuar, ndërsa pesë (5) apo 50% e tyre nuk janë zbatuar.

Gjatë përpilimit të parashikimeve makro-fiskale, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) vazhdimisht përdorë të dhënat e publikuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), siç janë: të dhënat e informalitetit të integruara në BPV, të dhënat për hartimin e buletinëve ekonomikë tremujorë dhe dokumenteve tjera të publikuara në web-faqen e MFPT-së, të përgatitura nga Departamenti i Politikave Ekonomike dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar Financiar. Gjithashtu, vlerësimi i hendekut tatimor i kryer përmes asistencës teknike të Bankës Botërore është bazuar në Anketën e Buxhetit të Ekonomive Familjare të ASK-së.

Agjencia e Statistikave të Kosovës ka shënuar progres lidhur me përpilimin e të dhënave të ekonomisë joformale në harmoni të plotë me metodologjinë dhe standardet ndërkombëtare, ku për herë të parë ka integruar të dhënat e ekonomisë joformale në të dhënat e BPV-së për aktivitetet ekonomike në vijim: 49-Transporti tokësor, 55- Akomodimi dhe 56-Aktivitetet e shërbimit të ushqimit dhe pijeve, si rezultatet i projektit të financuar nga Banka Botërore. Poashtu ka implementuar metodologjinë e Eurostatit dhe OECD-së për komponentët në vijim: vlerësimi i ekonomisë joformale sipas kontrolleve fiskale të ATK-së; vlerësimi i ekonomisë joformale sipas Metodës së Inputit të Punës (LIM); vlerësimi i trafikimit të drogës dhe vlerësimi i ekonomisë joformale për llojin N6: Prodhuesit që keqraportojnë qëllimisht për personat e vetëpunësuar dhe llojin N1: Prodhuesit që nuk regjistrohen qëllimisht për personat e vetëpunësuar. Ndërsa, për shkak të mungesës së stafit dhe ndikimit të pandemisë nuk është realizuar Anketa për çmimet e tokës bujqësore nga ASK.

Në mars të vitit 2022, MFPT ka përgatitur me sukses udhëzuesin mbi Metodologjinë e Vlerësimit të impaktit të ndryshimeve tatimore dhe ka kërkuar asistencë teknike për zbatimin e tij para miratimit të çdo mase fiskale të propozuar.

Lidhur me specifikimin në Thesar të komponentëve të pagesave nga tatimpaguesit (gjobë, ndëshkim, interes, shmangie tatimore dhe lloj tatimi), MFPT ka krijuar kodet në planin kontabël në të cilin identifikohen llojet e të hyrave, përkatësisht për gjoba, ndëshkim, interes, shmangie tatimore dhe lloj tatimi, mirëpo në Thesar në praktikë nuk bëhet një ndarje e tillë e të hyrave.

Banka Qendrore e Kosovës (BQK) në vitin 2021 ka miratuar Udhëzuesin për përdorimin e formularit mbi prejardhjen e fondeve dhe përcaktimin e mbajtësit të pronësisë përfituese, përmes së cilit BQK ka rritur mbikqyrjen për përshkrimin e transaksioneve financiare nga bankat, në mënyrë që të rritet dobia e informacionit për analiza cilësore në organet përkatëse.

Sa i përket krijimit të një sistemi ndërbankar të pagesave me qëllim të stimulimit të pagesave me kartelë dhe formave të tjera të pagesave, duke zvogëluar në masë përdorimin e kesh-it si mjet pagese, është iniciuar studimi i fizibilitetit, i cili është duke u kryer nga Banka Botërore me qëllim të identifikimit të zgjidhjeve të mundshme për krijimin e një sistemi të pagesave të shpejta.

Ndërsa lidhur me dhënien e kredive bankare bazuar në pasqyrat financiare të dorëzuara në ATK dhe të certifikuara nga ekspertët e lëmisë për të gjitha bizneset që janë të obliguara të dorëzojnë pasqyrat në këtë institucion, BQK ka përditësuar Rregulloren për Regjistrin e Kredive të aprovuar nga Bordi në Shtator 2019, ku lejohet mbledhja e të dhënave alternative, përfshirë të dhënat nga ATK. Në mënyrë që të finalizohet si projekt, kërkohen zhvillime në sistemin e Regjistrit të Kredive, të cilat janë planifikuar të realizohen gjatë vitit 2023.

Ndërsa nuk ka pasur progres në publikimin e të dhënave të fushës së financave publike në Portalin Kombëtar për të Dhëna të Hapura, megjithatë Agjencia e Shoqërisë së Informacionit (ASHI) ka bërë të gjitha përgatitjet e duhura që në E-Kosova të fillohet me publikimin e të dhënave.

Njësia e Inteligjencës Financiare (NJIF) në lidhje me vlerësimin e rrezikut specifik sektorial, gjatë vitit 2021 ka prioritetizuar vlerësimet e sektorëve në vijim: Vlerësimi i rrezikut sektorial regional në Personat juridik dhe Marrëveshjet në Kosovë; Vlerësimi i Rrezikut Specifik Sektorial për Financimin e Terrorizmit për OJQ-të në vendet e Ballkanit Përendimor dhe Turqi, i zhvilluar në kuadër të Këshillit të Evropës. Kurse gjatë vitit 2022 ka prioritetizuar vlerësimet e sektorëve të mëposhtëm: Vlerësimi i rrezikut të pastrimit të parave nëpërmjet produkteve bankare të ofruara në Kosovë, i cili është inicuar në shtator 2022 dhe do të zhvillohet gjatë periudhës shtator 2022 - qershor 2023; Vlerësimi i rrezikut Specifik Sektorial për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit për OJQ-të në RKS, i cili është inicuar në TM4 2022 dhe do të zhvillohet gjatë periudhës dhjetor 2022 - gusht 2023; Vlerësimi i rrezikut sektorial regional në Personat juridik dhe Marrëveshjet në vendet e Ballkanit Përendimor (Regional Risk Assessment of Legal Entities and Arrangements) është inicuar në TM4 2022 dhe do të zhvillohet gjatë periudhës dhjetor 2022 - gusht 2023.

Në Objektivin specifik 1.2 është synuar rritja cilësore e përmbushjes vullnetare përmes ngritjes së vetëdijes, raportimit dhe masave ligjore të kufizimit.

Ky objektiv përmban gjithsej njëzetë (20) aktivitete, njëmbëdhjetë (11) apo 55% prej të cilave janë zbatuar, ndërsa nëntë (9) apo 45% e tyre nuk janë zbatuar.

Sa i përket rritjes së aktiviteteve të komunikimit me publikun për të rritur shkallën e ndërgjegjësimit të qytetarëve nga organet përgjegjëse për zbatimin e Strategjisë Kombëtare, gjatë vitit 2022 MFPT ka publikuar Raportin Gjashtëmujor Janar-Qershor 2022 mbi zbatimin e Strategjisë Kombëtare 2019-2023.

Lidhur me këtë aktivitet, Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), në mënyrë që tatimpaguesit të njihen me procedurat e kërkuara me legjislacionin tatimor, risitë dhe ndryshimet tjera, gjatë periudhës raportuese ka përgatitur: njoftime për tatimpagues përmes mediave, ueb-faqes së ATK-së, rrjeteve sociale dhe adresave elektronike të tatimpaguesve; komunikata; intervista për mediat e shkruara dhe elektronike; fletushka si dhe në vazhdimësi ka shqyrtuar kërkesat e parashtruara nga tatimpaguesit në afatin e paraparë ligjor. Gjatë vitit 2021, ATK ka publikuar dhe dërguar tek tatimpaguesit njoftimet si në vijim:

- Njoftim për tatimpagues - Aktivitete intensive – Përmbushja në Sektorin e Ndërtimtarisë; Njoftim nga ATK - Publikimi i Broshurës – “Përmbushja tatimore”; Njoftim për Tatimpagues - Përfitoni nga Pakoja e Ringjalljes Ekonomike; Njoftim për tatimpagues - Paguaj borxhin!; Njoftim për Tatimpagues - Certifikata e të punësuarit shkarkohet përmes Sistemit EDI; Njoftim për Tatimpagues - Punësimi jo-formal, në fokus nga ATK!; Njoftimi në ueb-faqe-TATIMPAGUESIT

JO-AKTIV; Njoftim për Tatimpagues - Regjistro mallrat në stoqe!; Njoftim për të punësuarit - Verifikohu nëse jeni i regjistruar nga punëdhënësi për Tatimpagues; Detyrimet tatimore për të ardhurat e realizuara nga kriptovalutat;

- Një komunikatë për media dhe tri (3) seminare.

Ndërsa gjatë vitit 2022, ATK ka publikuar dhe dërguar tek tatimpaguesit njoftimet si në vijim:

- 32 Njoftime për Tatimpagues: ATK nxjerr Vendimin Shpjegues Publik Nr. 01/2022 për procedurat e trashëgimisë ligjore të Biznesit Individual pas vdekjes së pronarit; Njoftim për Ofruesit e huaj për shërbimet e furnizuara në mënyrë elektronike; Njoftim për Tatimpagues – ATK organizon seminarin virtual me datë 02.03.2022; Njoftim për Tatimpagues – Dorëzimi i raportit për transaksionet e kontrolluara për vitin 2021; Njoftim për tatimpagues - Regjistro punëtorët dhe mbaj tatimin në burim; Njoftim për tatimpagues - ATK verifikon mallrat pa origjinë; Njoftim për tatimpagues - Regjistroni veprimtaritë ekonomike dhe deklaroni të punësuarit tuaj!; Njoftim për Tatimpagues - Deklaro Pasqyrat Financiare përmes Sistemit elektronik EDI!; Njoftim për Tatimpagues - Deklarimi elektronik i Librit të Blerjes dhe Librit të Shitjes; Njoftim për tatimpagues - ATK në implementim të Projektit “Përmbushja në sektorin e akomodimit dhe shërbimit ushqimor”; Njoftim për tatimpagues - ATK në implementim të Projektit “Mungesa në stoqe dhe malli pa origjinë”; Njoftim për tatimpagues - ATK në implementim të Projektit “Mosdeklaruesit”; Njoftim për tatimpagues - Publikimi i Broshurës “Karta e tatimpaguesit”; Njoftim për tatimpagues - seminari virtual – Rimbursimet tatimore; Njoftim për tatimpagues - ATK edhe me një shërbim të ri elektronik – Formulari DI!
- Organizimi i shtatë (7) seminareve.

Dogana e Kosovës (DK) gjatë vitit 2021 ka bërë 363 paraqitje në media dhe ka mbajtur nëntë (9) konferenca për shtyp për ndërgjegjësimin e publikut dhe promovimin e luftës kundër ekonomisë joformale. Kurse, gjatë vitit 2022 ka bërë 98 paraqitje në media, ka mbajtur tri (3) konferenca për shtyp për ndërgjegjësimin e publikut dhe promovimin e luftës kundër ekonomisë joformale si dhe ka zhvilluar 15 aktivitete vetëdijesuese në fushën e Pronësisë Intelektuale. Poashtu ka publikuar aplikacionin për telefona të mençur i cili u mundëson qytetarëve dhe i fton ata të jenë pjesë aktive e parandalimit dhe raportimit të korrupsionit, kontrabandës dhe parregullsive tjera.

Lidhur me rritjen e numrit të konferencave, punëtorive dhe takimeve të përbashkëta me shoqatat profesionale për të diskutuar ndikimin e masave të luftës kundër ekonomisë joformale, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare, institucionet përgjegjëse kanë kryer aktivitetet si në vijim: Administrata Tatimore e Kosovës gjatë vitit 2021 ka mbajtur gjithsej 209 takime me tatimpagues, ka ofruar 397 shërbime për tatimpagues nga Zyra Qendrore dhe 190,858 shërbime nga Zyrat Regjionale. Kurse, gjatë vitit 2022 ka mbajtur gjithsej 413 takime me tatimpagues, ka ofruar 797 shërbime për tatimpagues nga Zyra Qendrore dhe 233,325 shërbime nga Zyrat Regjionale. Poashtu ATK ka mbajtur takime me palët e interesit, siç janë: Odat ekonomike në Kosovë; Shoqata e Kontabilistëve të Certifikuar dhe Auditorëve të Kosovës (SHKÇAK), Instituti AAB për Kontabilistë dhe Auditorë të Certifikuar, Instituti për Kontabilitet, Auditim dhe Financa (IKAF), Rrjeti i Shitësve me Pakicë, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Dogana e Kosovës, Thesari, etj.

Dogana e Kosovës gjatë vitit 2021 ka mbajtur 21 takime me biznese dhe shoqata të ndryshme në përkrahje të bizneseve në deklarin vullnetar, zbatimin ligjor dhe efikas të obligimeve. Ndërsa, gjatë vitit 2022 ka mbajtur 66 takime me biznese të ndryshme dhe me Shoqatën e Shpedicioneve, me Odën e Afarizmit të

Kosovës dhe Odën Ekonomike Gjermane. Gjithashtu Drejtori i Përgjithshëm i DK ka qenë pjesëmarrës në 9 seminare të ndryshme si panelist.

Njësia e Inteligjencës Financiare gjatë vitit 2022 ka marrë pjesë në mbi 40 aktivitete të konferencave, punëtorive, takimeve të përbashkëta vendore dhe ndërkombëtare. Krahasuar me vitin paraprak 2021, në vitin 2022 ka pasur rritje të aktiviteteve të tilla për 54%. Janë zhvilluar takime me Shoqatën e Bankave të Kosovës, Odën e Noterëve, Shoqërinë Civile dhe OJQ-të. Janë zhvilluar pesë (5) punëtori dhe seminare të partneritetit Publiko-Privat, në të cilat janë ftuar Shoqata e Bankave, Oda e Noterëve, Oda e Avokatëve, Shoqata e Kontabilistëve dhe Auditorëve, AMIK, Shoqata e Sigurimeve, etj.

Lidhur me pasqyrimin e të ardhurave nga ekonomia joformale gri dhe e zezë në raportin vjetor të zbatimit të Strategjisë Kombëtare, MFPT në Raportin gjashtëmuor 2022 mbi zbatimin e Strategjisë Kombëtare ka publikuar të dhënat për të ardhurat nga ekonomia joformale për institucionet përkatëse. Administrata Tatimore e Kosovës, përkatësisht Njësia e Hetimeve Tatimore dhe Inteligjencës ka ndërmarrë disa aktivitete lidhur me ekonominë joformale në bashkëpunim me NJIF dhe DK. Tabela në vijim pasqyron gjetjet për shmangiet tatimore, ndëshkimet dhe interesat për periudhën 2021-2022.

Tabela 2. Gjetjet për shmangiet tatimore, ndëshkimet dhe interesat për periudhën 2021-2022 (në EUR)

	2021	2022
Njësia e hetimeve tatimore		
Numri i aktiviteteve	68	101
Shmangia tatimore (pa ndëshkime)	2,223,894.00	3,542,603.00
Divizioni i Inteligjencës		
Numri i aktiviteteve	184	131
Tatimi shtesë (pa ndëshkime)	4,833,038.07	3,601,880.15
Zvogëlimi i kreditimit	270,158.45	130,189.61
Zvogëlimi i humbjes	280,545.62	104,654.11

Burimi: Administrata Tatimore e Kosovës

Bazuar në informatat kthyese nga Raportet e Inteligjencës drejtuar Drejtorive Rajonale të ATK-së për vitin 2022, këto raporte kanë rezultuar me tatim shtesë (pa ndëshkime dhe interes) në vlerë prej 3,601,880.15 EUR, zbritje të kreditimit në vlerë prej 130,189.61 EUR dhe zvogëlim të humbjeve në vlerë prej 104,654.11 EUR.

Të hyrat e përgjithshme doganore për vitin 2022 janë rritur për 156.9 milion EUR ose shprehur në përqindje 11.45% më shumë se në vitin paraprak. Është tejkalluar projeksioni i rishikuar i Qeverisë me rreth 3% apo rreth 50 milion EUR mbi projeksionin e rishikuar. Janë evidentuar rreth 22.8 milion EUR të hyra nga aktivitetet e luftimit të ekonomisë joformale, siç janë: të hyrat nga rivlerësimi i mallrave, të hyrat nga kundërvajtjet dhe dënimet, të hyrat nga mosdeklarimi i mjeteve monetare dhe të hyrat nga shitja e mallrave të konfiskuara.

Tabela 3. Të hyrat e Doganës së Kosovës nga aktivitetet e luftimit të ekonomisë joformale për periudhën 2021-2022 (në EUR)

	2021	2022
Të hyrat nga rivlerësimi i mallrave	21,005,105.30	20,519,239.81
Të hyrat nga kundërvajtjet dhe dënimet	1,387,443.47	2,058,368.12
Të hyrat nga mosdeklarimi i mjeteve monetare	29,546.93	138,615.88
Të hyrat nga shitja e mallrave të konfiskuara	184,346.61	173,805.17
Gjithsej	22,606,442.31	22,890,028.98

Burimi: Dogana e Kosovës

Sa i përket përgatitjes dhe publikimit të fletëpalosjes me informacion për publikun rreth efektit të pritur në parandalimin e ekonomisë joformale nga zbatimi i masave të parapara sipas nenit 64 të MSA mbi sistemet e Pagesave, Banka Qendrore e Kosovës në vazhdimësi publikon materiale statistikore dhe informative mbi sistemet dhe instrumentet e pagesave, siç është inkurajimi i përdorimit të kartelave bankare. Në vijim është paraqitur numri i përgjithshëm i transaksioneve të realizuara në POS terminale të bankave raportuese brenda vendit dhe përqindja e rritjes vjetore të këtyre transaksioneve përgjatë tri viteve të fundit. Gjatë vitit 2021 janë shënuar rreth 10.6 milion transaksione me kartelë në POS terminale apo 2.3% më shumë krahasuar me vëllimin e transaksioneve të vitit paraprak. Një rritje më e lartë e përdorimit të kartelave u vërejt gjatë vitit 2020 si rezultat i pandemisë, me qëllimin e reduktimit të mundësisë së përhapjes të virusit Covid-19 gjatë procesit të kryerjes së pagesave, e cila shihet se ka vazhduar edhe në vitin 2021. Gjithashtu, edhe amandamentimi i rregullores për instrumentet e pagesave elektronike me të cilën janë eliminuar tarifat për klientin me rastin e kryerjes së pagesës në POS terminal të bankave, rezulton të ketë qenë me ndikim në rritjen e pagesave me kartelë.

Tabela 4. Numri i transaksioneve në POS terminale gjatë tri viteve të fundit

	2019	2020	2021
Numri i përgjithshëm i transaksioneve në POS terminale	6,662,772	10,354,292	10,593,763
Përqindja e vjetore e rritjes	14.4 %	55.4%	2.3%

Burimi: Banka Qendrore e Kosovës

Gjatë periudhës raportuese nuk është kryer ndonjë studim lidhur me procesin e vlerësimit të çmimit të pronës, regjistrimit të të patundshmeve në rast blerjeje për herë të parë apo transferimi në mënyrë që vlera e asetit të regjistruar të pasqyrojë vlerën aktuale të tregut. Megjithatë, MFPT publikon çdo vit raportet vjetore të vlerësimit masiv të pronave të paluajtshme për qëllime të tatimit në pronë për secilën Komunë.

Projekti i unifikimit të adresave është në proces. Gjatë periudhës raportuese nga 55 konsulentë të nevojshëm që të ndihmojnë Komunitat në azhurnimin e të dhënave për Sistemin e Adresave në aplikacionin ARIS, është arritur të angazhohen njëzet e një (21) prej tyre, kurse është duke u zhvilluar procedura e prokurimit për angazhimin e tridhjetë e katër (34) konsulentëve tjerë. Janë angazhuar katër (4) konsulentë në Agjencinë Kadastrale të Kosovës për të ndihmuar Njësinë e Adresave për menaxhimin e aktiviteteve

për sistemin e adresave. Janë përgatitur edhe specifikat teknike për vendosjen e tabelave të rrugëve dhe numrat e objekteve për Komunat e mbetura. Me iniciativë të Zyrës së Kryeministrit dhe përkrahje të GIZ është duke u implementuar pilot projekti për lidhjen e adresave me Regjistrin Civil në Komunat Istog dhe Mitrovicë e Jugut. Rezultatet e këtij pilot projekti do të shërbejnë për lidhjen e adresave me Regjistrin Civil në të gjitha Komunat tjera.

Në kuadër të infrastrukturës ligjore, tatimi mbi të ardhurat personale në ATK edhe nga personat fizik jo afarist deri më tani është bërë në kuadër të deklaratës vjetore për të ardhurat personale. Nga 1 janar 2023 personat fizik do të deklarojnë Tatimin në të Ardhura Personale për Individ përmes formularit të veçantë DI (Deklarata Individuale). Ndërsa, përgatitja e koncept dokumentit lidhur me dorëzimin e deklaratës vjetore familjare të tatimit mbi të ardhurat personale në ATK edhe nga personat fizik jo afarist nuk është zbatuar ende.

Sfidë për luftimin e ekonomisë joformale mbetet pagesa e të punësuarve përmes bankës. Në këtë drejtim, puna e padeklaruar vazhdon të jetë faktori kyç në mosrealizimin e plotë të këtij qëllimi. Ligji për Administrimin e Procedurave Tatimore do të përfshijë dispozitën e cila obligon që pagat e të punësuarve nga ana e punëdhënësit të bëhen nëpërmjet sistemit bankar. Ky ligj pritet të dalë shpejt në konsultime publike dhe më pas të procedohet më tutje.

Në anën tjetër, Administrata Tatimore e Kosovës ka vazhduar me pajisjen e bizneseve me arkë fiskale, ku numri i këtyre bizneseve është gjithnjë e në rritje. Tabela në vijim paraqet numrin e bizneseve të fiskalizuara gjatë periudhës raportuese.

Tabela 5. Numri i bizneseve të fiskalizuara gjatë periudhës 2021-2022

	2021	2022
Numri i bizneseve	3,009	3,826
Numri i PEF të instaluar	4,387	5,487

Burimi: Administrata Tatimore e Kosovës

Ndërsa, sa i përket vizitave për mos lëshim të kuponëve fiskal, tabela në vijim paraqet numrin e vizitave për pajisjen me arkë fiskale, numrin e gjobave dhe vlerën për periudhën 2021-2022.

Tabela 6. Numri i vizitave në biznese për pajisjen me arkë fiskale, numri dhe vlera e gjobave gjatë periudhës 2021-2022

	2021	2022
Numri i vizitave për pajisjen me arkë fiskale	3,200	1,340
Numri i gjobave	1,223	444
Vlera e gjobave (EUR)	187,850	71,625
Numri i vizitave për mos lëshimin e kuponëve fiskal	4,954	2,628
Numri i gjobave	6,826	3,022
Vlera e gjobave (EUR)	1,438,550	710,500

Burimi: Administrata Tatimore e Kosovës

Sa i përket implementimit të faturës elektronike në sistemin e ri të TI-së, ATK përkundër angazhimit maksimal që ta implementojë atë, një gjë të tillë nuk e ka realizuar, meqë Operatori Ekonomik ka dështuar që ta implementojë E-Faturën.

Lidhur me plotësim/ndryshimin e Ligjit për Financimin e Partive Politike, Ligji ka hyrë në fuqi me datën 20.09.2022. Ky Ligj ka përcaktuar përgjegjësi shtesë për Zyrën për Regjistrimin, Certifikimin dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike (ZRCKFSP), ku përzgjedhja e auditorëve të licencuar për auditim të raporteve vjetore të partive politike do të iniciohet dhe mbikëqyret nga ZRCKFSP.

Ndërsa, sa i përket auditimit të pavarur të financave të partive politike, Raportet vjetore financiare të partive politike për vitin 2021 janë publikuar, por nuk janë të audituara. Ndërsa, raportet e audituara për vitin 2022 pritet të publikohen nga KQZ në qershor 2023.

Në kuadër të Policisë së Kosovës, konkretisht brenda strukturës së Drejtorisë për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit ekziston një zyrë për Rikthim e Pasurisë (Aseteve). Kjo zyrë zanafillën e ka nga viti 2018. Deri më tani kjo zyre ka punuar me rastet/kërkesat ndërkombëtare përmes ILECU-së, kërkesat e organizatës ndërkombëtare Carin si dhe ndihmat ndërkombëtare Juridike përmes Autorizimeve të Prokurorisë për identifikimin e asetëve. Gjatë vitit 2021, Njësia për rikthimin e asetëve të konfiskuara ka trajtuar 41 kërkesa në mesin e të cilave 15 ishin autorizime të Prokurorisë, 10 raste përmes ILECU-së dhe 16 raste përmes rrjetit Carin. Kurse, gjatë vitit 2022 janë trajtuar gjithsej gjashtëmbëdhjetë (16) kërkesa nga shtete të ndryshme dhe 12 Autorizime nga Prokuroritë kompetente.

Ndërsa, lidhur me krijimin e fondit të konfiskimit, Ministria e Drejtësisë gjatë periudhës raportuese ka themeluar grupin punues për hartimin e kësaj politike, përmes Koncept Dokumentit për krijimin e fondit të konfiskimit. Ky Koncept Dokument u miratua nga Qeveria e Republikës së Kosovës me 23 qershor 2022. Sipas Opsionit të rekomanduar në këtë Koncept Dokument do të ndryshohet/plotësohet Ligji për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar (AAPSK) si dhe Ligji Vjetor për buxhetin.

Përgjatë periudhës raportuese, Policia e Kosovës dhe Prokuroria e Shtetit kanë zhvilluar hetime në fushën e krimeve financiare të cilat kanë rezultuar në ngritjen e aktakuzave si dhe konfiskimin e pasurisë së fituar me vepër penale në përputhje me rekomandimet e FATF-së. Policia e Kosovës në të gjitha rastet ku dyshohet për përfitim të kundërligjshëm të pasurisë zhvillon edhe hetime financiare. Brenda Policisë së Kosovës ekzistojnë dy Sektorë që zhvillojnë Hetime Financiare dhe për vitin 2021 janë zhvilluar hetime për 71 raste, kurse gjatë vitit 2022 janë zhvilluar hetime për 60 raste. Policia e Kosovës së fundi i kushton rëndësi të madhe hetimeve paralele financiare në raste të cilat i heton. Gjatë vitit 2022 janë zhvilluar hetime financiare paralele për 4 raste. Ndërsa, Prokuroria e Shtetit ka vazhduar me aktivitetet e saj, ku gjatë vitit 2021 ngrirja/sekuestrimi arrin vlerën prej 14,238,163.89 EUR dhe konfiskimi përfundimtar 772,819.42 EUR. Ndërsa për vitin 2022 ngrirja/sekuestrimi arrin vlerën prej 20,728,965.42 EUR dhe konfiskimi përfundimtar 669,765.14 EUR.

Lidhur me shtimin e aktivitetëve hetimore për veprat penale kundër ekonomisë siç është e përcaktuar në Kodin Penal të Kosovës, institucionet përgjegjëse kanë zbatuar me sukses aktivitetet e tyre si në vijim:

Policia e Kosovës - Për vitin 2021, bazuar në Kodin Penal të Republikës së Kosovës, Veprat Penale që lidhen me Krime Ekonomike janë: Kapitulli XXV veprat penale kundër ekonomisë me 82 vepra penale; Kapitulli XXVI veprat penale kundër pasurisë me 23 vepra penale; Kapitulli XXXI veprat penale kundër administrimit të drejtësisë dhe administratës publike me 56 vepra penale; Kapitulli XXXIII Korrupsioni zyrtar dhe Veprat penale kundër detyrës zyrtare me 178 vepra penale apo gjithsej 339 vepra penale. Ndërsa për vitin 2022, Veprat Penale që lidhen me Krime Ekonomike janë: Kapitulli XXV veprat penale kundër ekonomisë me 61 vepra penale; Kapitulli XXVI veprat penale kundër pasurisë me 31 vepra penale; Kapitulli XXXI veprat penale kundër administrimit të drejtësisë dhe administratës publike me 56 vepra penale; Kapitulli XXXIII Korrupsioni zyrtar dhe Veprat penale kundër detyrës zyrtare me 172 vepra penale, apo gjithsej 320 vepra penale.

Prokuroria e Shtetit gjatë periudhës raportuese ka zhvilluar aktivitetet si në tabelën e mëposhtme.

Tabela 7. Aktivitetet lidhur me veprat penale të krimeve ekonomike, shpërlarjes së parasë, krimit të organizuar dhe korrupsionit në kuadër të Prokurorisë së Shtetit për periudhën 2021-2022

	2021	2022
Veprat penale të krimeve ekonomike		
Numri i rasteve penale	467	398
Numri i personave	644	593
Numri i veprimeve/vendimeve të ndërmarra	426	304
Veprat penale të shpërlarjes së parasë		
Numri i rasteve penale	9	14
Numri i personave	19	24
Numri i veprimeve/vendimeve të ndërmarra	27	20
Vepra penale Krim i organizuar		
Numri i rasteve penale	19	14
Numri i personave	148	116
Numri i veprimeve/vendimeve të ndërmarra	176	66
Vepra penale Korrupsioni		
Numri i rasteve penale	485	560
Numri i personave	1,046	1,140
Numri i veprimeve/vendimeve të ndërmarra	707	89

Burimi: Prokuroria e Shtetit

Dogana e Kosovës - Gjatë vitit 2022, në fushën e hetimit doganor janë iniciuar 91 raste të reja për hetime dhe janë dorëzuar 69 kallëzime penale pranë prokurorive përgjegjëse, ku janë siguruar prova të mjaftueshme se kemi të bëjmë me shmangie nga detyrimet doganore në vlerë prej 2.87 milion EUR si dhe janë sekuestruar mallra në vlerë prej 1.86 milion EUR. Vlera e mallrave të sekuestruara nga veprat penale është rritur për 36% krahasuar me vitin 2021, ndërsa numri i personave të arrestuar është rritur për 23%.

Tabela 8. Aktivitetet hetimore doganore për veprat penale kundër ekonomisë për periudhën 2021-2022

	2021	2022	Diferenca
Raste të reja nën hetime	96	91	-5.20%
Kallëzime penale	84	69	-18.82%
Vlera e shmangieve të argumentuara (EUR)	2,714,962.41	2,873,093.20	5.82%
Vlera e mallit të Sekuestruar (EUR)	1,376,181.59	1,868,951.67	35.80%
Numri i personave të intervistuar	136	201	47.79%
Numri i personave të arrestuar	13	16	23.07%

Burimi: Dogana e Kosovës

Poashtu gjatë vitit 2022, DK ka iniciuar 1,795 kundërvajtje doganore për shmangie të detyrimeve doganore dhe kontrabandës me mallra, me vlerë të mallrave prej 6.2 milion EUR, si dhe ka shqiptuar gjoba në vlerë prej 1.8 milion EUR.

Tabela 9. Kundërvajtjet doganore, vlera e mallit në kundërvajtje dhe vlera e gjobave të shqiptuara për periudhën 2021-2022

	2021	2022	Diferenca
Numri i kundërvajtjeve	1,774	1,795	1.18%
Vlera e mallit në kundërvajtje (EUR)	4,107,699.30	6,258,497.58	52.36%
Vlera e gjobave të shqiptuara (EUR)	1,366,161.77	1,852,666.00	35.61%

Burimi: Dogana e Kosovës

Administrata Tatimore e Kosovës ka vazhduar me trajtimin dhe hetimin e rasteve të cilat ndërlidhen me shmangien tatimore si në tabelën e mëposhtme.

Tabela 10. Trajtimi dhe hetimi i rasteve për shmangien tatimore për periudhën 2021-2022

	2021	2022
Aktiviteti dhe verifikimi i deklaratave të sakta	68	101
Intervistime	144	148
Konsultime me Prokurorë	150	73
Raste të hapura	58	25
Kallëzime Penale (raporte të dyshimit fillestar)	35	16
Bastisje	3	1
Raporte hetuese finale	27	14
Informata palëve të treta	263	255
Rezultatet nga shmangia tatimore pa ndëshkime dhe interes (EUR)	2,223,894.00	3,542,603.20

Burimi: Administrata Tatimore e Kosovës

Sa i përket Koncept dokumentit për përmirësimin e legjislacionit në fushën e Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit në përputhje me praktikën e BE-së, rekomandimet e PECK II, Raportit të Vendit 2018 për Kosovën dhe MSA (Neni 89), gjatë vitin 2022 janë miratuar dokumentet si në vijim:

- Ligji Nr. 08/L-146 për zbatimin e sanksioneve financiare ndërkombëtare të shënjestruara
- Koncept dokumenti për Regjistrin e Pronësisë Përfituese.

Ndërsa, gjatë vitit 2022 është finalizuar pjesa përmbajtësore e Koncept Dokumentit për trajtimin e legjislacionit në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit (PPP/LFT). Koncept dokumenti nuk është miratuar ende.

Në anën tjetër, ATK ka vazhduar me rritjen e numrit të vizitave dhe kontrolleve bazuar në vlerësimet e rrezikut, ku në vitin 2021 ka realizuar gjithsej 1,449 kontrollat bazuar në rrezik, ndërsa në vitin 2022 janë gjithsej 1,933 kontrolle të përfunduara, nga të cilat 1,278 janë kontrolle të bazuara në rrezik.

Tabela 11. Numri i kontrolleve dhe vlera e shmangies tatimore në EUR për periudhën 2021-2022

	2021	2022
Numri i kontrolleve	1,449	1,933
Tatimi bazë	39,426,628.16	32,621,989.06
Ndëshkimi	11,178,052.97	11,982,828.72
Interesi	7,511,709.54	4,786,567.39
Gjithsej tatimi	58,116,390.67	49,391,385.17

Burimi: Administrata Tatimore e Kosovës

Gjatë periudhës tatimore 2021-2022 janë zhvilluar një sërë vizitash dhe aktiviteteve të cilat i paraqesim në tabelën në vijim:

Tabela 12. Pasqyra e të dhënave lidhur me vizitat dhe aktivitetet sipas Drejtorive Rajonale (EUR) për periudhën 2021-2022

	2021	2022
Nr. i vizitave dhe aktiviteteve	40,415	36,855
Nr. i punëtorëve të regjistruar	3,758	4,130
Nr. i gjobave për mallra pa origjinë	326	470
Vlera e mallit pa origjinë	510,389	1,346,742
Ndëshkimi prej 25%	125,341	324,932
Mungesa në stoqe	25,508,214	414,503,190
Nr. i gjobave mandatore	13,723	12,053
Vlera e gjobave mandatore	2,812,000	3,648,200
Qarkullimi shtesë	135,058,173	199,877,723
Tatimi shtesë	9,209,990	11,737,621
Ulje e kreditimit	5,653,317	6,976,164

Zvogëlimi i humbjes	6,210,984	7,203,658
---------------------	-----------	-----------

Burimi: Administrata Tatimore e Kosovës

Ndërsa, Ligji për Administratën Tatimore dhe Procedurat, i hartuar nga grupi punues i formuar nga MFPT, është në fazën përfundimtare dhe pritet të dalë në konsultime publike.

Në **Objektivin specifik 1.3** është synuar përmirësimi cilësor i kapaciteteve institucionale dhe bashkërendimi për zbatim më të mirë të politikave të miratuara.

Ky objektivi përmban gjithsej dymbëdhjetë (12) aktivitete, prej të cilave nëntë (9) apo 75% janë zbatuar, ndërsa tre (3) apo 25% nuk janë zbatuar.

Bizneset në vend edhe gjatë periudhës raportuese kanë vazhduar me përditësimin dhe klasifikimin e aktiviteteve sipas nomenklaturës ndërkombëtare (NACE rev.2) dhe po ashtu ka vazhduar shkëmbimi i këtyre informatave ndërmjet ARBK-së, ATK-së dhe ASK-së.

Sa i përket intensifikimit dhe bashkërendimit të aktiviteteve në mes të ATK-së dhe ish-MPMS-së, me qëllim të identifikimit dhe regjistrimit të punëtorëve të pa regjistruar, gjatë periudhës raportuese ATK-ja ka ndërmarrë disa aktivitete dhe ka zhvilluar projektin e veçantë për punësimin joformal, për të cilin janë informuar të gjithë tatimpaguesit, palët e interesit, shoqatat e ndryshme, etj. Gjithashtu bazuar në analizën e riskut ka pasur aktivitete dhe kontrole për luftimin e punësimit joformal. Projekti është hartuar dhe ka filluar të zbatohet nga viti 2021. Bazuar në aktivitetet e propozuara nga analiza e riskut për vitin 2021 janë identifikuar 3,817 të punësuar si të padeklaruar nga punëdhënësit, janë zhvilluar 405 vizita, ndërsa për vitin 2022 janë identifikuar 4,130 të punësuar të padeklaruar, janë zhvilluar pesë (5) kontrole dhe 584 vizita.

Ndërsa, nuk është arritur ende memorandumi i mirëkuptimit në mes të Ministrisë së Drejtësisë dhe MFPT/ATK për të siguruar shkëmbimin e të dhënave nga noterët për transaksionet në patundshmëri, makina dhe qera, i cili si minimum të ofrojë informacion mbi numrin e transaksioneve, tipin, adresën, vlerën dhe subjektin. ATK aktualisht siguron qasjen në këto të dhëna në bazë të kërkesës. Në projektligjin për Administrimin e Tatimeve për ATK është përfshirë një dispozitë ligjore e veçantë e cila i obligon noterët që t'i dorëzojnë në ATK informatat për të gjitha kontratat e shitblerjeve nga personat juridik, personat fizik afarist dhe personat fizik jo-afarist. Projektligji është në fazën e diskutimit paraprak.

Poashtu, gjatë periudhës raportuese nuk është arritur të zhvillohen dhe prezantohen modulet e reja të programeve fiskale për të përmirësuar parashikimet fiskale për të ardhurat nëpër sektorë. Për prezantimin e modeleve të reja nevojitet që stafi i ri fillimisht të njihet plotësisht me modelin ekzistues si dhe me kursin online të Parashikimit të të Ardhurave të FMN-së e pastaj të vazhdojë me hapat përgatitorë të zhvillimit të kornizave të reja të parashikimit të zërave të të ardhurave specifike për sektorë. Si rezultat, për shkak të qarkullimit të madh të stafit gjatë vitit 2021 dhe 2022 brenda Divizionit të Makroekonomisë në kuadër të MFPT aktiviteti nuk ka pasur zbatim.

Në anën tjetër, NJIF-K ka bërë në vazhdimësi përditësimin dhe publikimin e listës së vendeve me rrezik të lartë në faqen zyrtare të NJIF.

Poashtu, gjatë vitit 2021 NJIF-K ka hartuar dhe zhvilluar dy metodologji të vlerësimit të rrezikut: - Metodologjia “Mjetet për Vlerësimin e Rrezikut të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit të Personave Juridike për Kosovën”.

- Metodologjia e Këshillit të Evropës në bashkëpunim me Shtetet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqinë për Vlerësimin e Rrezikut specifik për financim të terrorizmit përmes sektorit të OJQ-ve.

Ndërsa, gjatë vitit 2022 NJIF-K nën mbështetjen e Projekteve ndërkombëtare ka hartuar dhe zhvilluar tri metodologji të vlerësimit të rrezikut:

- Metodologjia për Vlerësimin Pastrimit të Parave në Sektorin Bankar dhe produktet bankare
- Metodologjia për vlerësimin e rrezikut të financimit sektorial të terrorizmit të organizatave jofitimprurëse (OJF)
- Mjeti për vlerësimin e rrezikut ndërkufitar të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit të personave juridikë për vendet e Ballkanit.

Sa i përket rritjes së veprimeve të koordinuara (kontroll/inspektim) të NJIF dhe organeve të zbatimit të ligjit në bizneset me rrezik të lartë (pjesë e listës së identifikuar nga NJIF), gjatë vitit 2021 janë zhvilluar 31 inspektime të pajtueshmërisë në sektorë të ndryshëm, ndërsa gjatë vitit 2022 janë zhvilluar 27 inspektime të pajtueshmërisë. Së bashku me institucionet tjara, siç është BQK, janë kryer inspektime të koordinuara dhe të përbashkëta në Këmbimore. Ndërsa, me kërkesë të NJIF, Policia e Kosovës gjatë vitit 2021 ka kryer 31 kontrole/inspektime të koordinuara me NJIF dhe organe tjera të ligjit në biznese me rrezik të lartë, kurse gjatë vitit 2022 janë realizuar 27 sosh. Dogana e Kosovës gjatë vitit 2021 ka dërguar në NJIF 34 kërkesa lidhur me transaksione të dyshimta, ndërsa nga NJIF ka pranuar 10 kërkesa për të cilat është kthyer përgjigje. Kurse, gjatë vitit 2022 ka dërguar në NJIF 9 kërkesa lidhur me transaksione të dyshimta, ndërsa nga NJIF ka pranuar 3 kërkesa për të cilat është kthyer përgjigje dhe janë dërguar 10 shënime/informata për mosdeklarim të mjeteve monetare.

Lidhur me rritjen e inspektimeve dhe aktiviteteve të mbikëqyrjes së pajtueshmërisë në zyrat noteriale dhe agjencitë e paluajtshëmive, për të vlerësuar pajtueshmërinë e subjekteve raportuese me Ligjin për PPP dhe FT, NJIF gjatë vitit 2021 ka bërë 24 inspektime në sektorin e Noterisë, ndërsa në vitin 2022 ka bërë 20 sosh.

Sa i përket bashkëpunimit funksional nga ATK dhe DK me Administratat e huaja tatimore dhe doganore përmes nënshkrimit të Marrëveshjeve të Mirëkuptimit, për forcimin e shëmbimeve ndërkombëtare të informacionit e veçanërisht lidhur me kompaninë amë apo ato të linjës, Dogana e Kosovës ka hapur zyret për zhdoganimin e mallrave në portet detare të Durrësit dhe atë të Porto Romanos. Është nënshkruar Protokollin për njohjen e plumbçeve mes Doganës së Republikës së Kosovës dhe Doganës së Republikës së Shqipërisë si dhe Protokollin zbatues për funksionimin e profileve të riskut në zbatim të procedurave të transitit të mallrave përmes territorit të Republikës së Shqipërisë në territorin e Kosovës dhe anasjelltas. Ndërsa, ATK aktualisht ka dy marrëveshje me dy shtete: Shqipërinë dhe Estoninë. Kurse, për eliminimin e tatimit të dyfishtë (METD) deri më tani janë 21 Marrëveshje, ku në kuadër të këtyre Marrëveshjeve, përmes neneve të veçanta është specifikuar shkëmbimi i të dhënave me këto shtete.

Për tu rritur cilësia e monitorimit dhe procedurave penale të ndërtimeve për të zvogëluar ndërtimin e kundërligjshëm dhe ndërtimin e ndërtesave që nuk i përmbushin specifikacionet e kërkuara, Inspektorati i MMPHI-së, sektori i Ndërtimit dhe planifikimit, gjatë periudhës raportuese ka realizuar pesëdhjetë e tri (53) inspektime ndaj subjekteve ekonomike, personave fizik si dhe ndaj inspektoratit komunal. Për shkeljet e konstatuara janë ngritur dy (2) kallëzime penale pranë prokurorive themelore.

Kurse sa i përket ngritjes së kapaciteteve të stafit, ASK gjatë periudhës raportuese ka vazhduar me ngritjen e kapaciteteve të stafit në Divizionin e Ekonomisë joformale dhe llogarive qeveritare. Ndërsa, për shkak të mungesës së asistencës teknike, trajnimi për “Forecast consolidation” i Divizionit të Politikave Fiskale nuk është mbajtur.

Në Objektivin specifik 1.4 është synuar zvogëlimi i punësimit joformal në Kosovë. Aktivitetet e parapara në kuadër të këtij objektiv janë të natyrës vetëdijuese për publikun dhe përmirësimit të kushteve të punës për organet zbatuese.

Ky objektiv përmban gjithsej njëmbëdhjetë (11) aktivitete, nga të cilat shtatë (7) apo 64% e tyre janë zbatuar, ndërsa katër (4) apo 36% e tyre nuk janë zbatuar.

Lidhur me organizimin e fushatave informuese për publikun dhe punëdhënësit, MFPT në bashkëpunim me Inspektoratin e Punës, ATK, MBPZHR dhe partnerët tjerë gjatë vitit 2021 ka përgatitur konceptin e fushatës së parë informuese me fokus në ngritjen e vetëdijes së punëtorëve dhe kompanive për dobitë e punës së deklaruar. Fushata “Fito. Deklaro. Përfito” është bazuar në idenë e fushatës së mediave sociale në mbarë BE-në që është udhëhequr nga Komisioni Evropian dhe që është zbatuar në Shtetet Anëtare të BE-së në vitin 2020. Hapja e fushatës është bërë në muajin qershor 2021 përmes organizimit të një Konference ku është prezentuar koncepti i fushatës dhe prezantimi i Raportit për analizën e gjendjes së sektorit dhe praktikave të mira. Ndërsa, gjatë vitit 2022 MFPT ka dizajnuar konceptin e radhës së fushatës informuese për të drejtat e punës. Institucionet implementuese ishin Inspektorati i Punës dhe ATK. Partnerë tjerë implementues ishin ILO, UNWOMEN dhe OJQ-të, të cilat promovojnë dhe avokojnë për të drejtat e punës, me fokus punën e padeklaruar. Fushata është hapur në dhjetor të vitit 2022, ndërsa po vazhdon të implementohet edhe në vitin 2023. Sllogani i fushatës është “Punë e denjë për një jetë të dinjitetshme”. Në kuadër të aktiviteteve, pjesa e formalizimit të vendeve të punës ka vëmendje të shtuar në këtë fushatë. Gjithashtu në muajin dhjetor është organizuar fushatë një javore së bashku me ATK për formalizimin e vendeve të punës dhe dialogun social. Fushata është organizuar në bashkëpunim me OJQ “IKSI”, në 5 regjione me grupe të grave dhe të rinjë punëmarrës dhe punëdhënës të sektorit të prodhimit.

Sa i përket angazhimit të palëve të interesit dhe publikut të gjerë në adresimin e punësimit joformal, adresimi i punës së padeklaruar dhe përfshirja e grupeve të interesit ka vazhduar edhe përgjatë vitit 2021 dhe 2022. Institucionet kyçe në luftimin e punës së padeklaruar (ATK dhe IP) kanë rritur nivelin e bashkëpunimit në adresimin e punës së padeklaruar. Përfshirja e shoqërisë civile ka qenë e theksuar në promovimin e punës së padeklaruar. Përmes promovimit të të drejtave të punës dhe zgjerimit të interesimit për forcimin e dialogut social në nivel vendi, MFPT ka arritur që të përfshijë OJQ si partnerë implementues në promovimin e punës së padeklaruar së bashku me disa dy organizata ndërkombëtare (ILO dhe UN WOMEN).

Raporti mbi analizën e situatës dhe vlerësimin mbi praktikave të mira fizibile të Kosovës në reduktimin e punësimit të padeklaruar (gjashtë nën raporte/analiza) është hartuar dhe publikuar në vitin 2021. Ndërsa, në kuadër të këtij raporti, është përgatitur edhe analiza lidhur me krijimin e regjistrimit të punësuarve në Kosovë.

Lidhur me përgatitjen e udhëzuesit për metodologjinë e vlerësimit të shkallës së rrezikshmërisë së rasteve/prioritizimi dhe vendosja e planit të inspektimit dhe trajnimit të stafit përkatës për përdorimin e metodologjisë, aktiviteti nuk është zbatuar pasi që është i ndërlidhur me zhvillimin e sistemit informativ të Inspektoratit të Punës. Aktualisht është duke u ndërtuar sistemi informativ brenda IP në bashkëpunim me donatorët. Ndërsa, ATK, përkatësisht Departamenti i Analizes së riskut ka mënyra të vlerësimit të shkallës së rrezikshmërisë për raste dhe priorizon dhe vendosë planin për trajtim në baza vjetore.

Sa i përket zhvillimit të manualit/procedurave të veprimit për inspektim, Manuali mbi Procedurat e Inspektimit është hartuar dhe është dorëzuar tek Inspektorati i Punës.

Ndërtimi i një sistemi monitorues dhe sistemit për vlerësimin e performancës së punës së inspektorëve është në proces të zbatimit. Me mbështetjen e donatorëve ka nisur procesi i hartimit të Planit të ri Zhvillimor të IP. Në kuadër të këtij plani janë përcaktuar të gjithë hapat e nevojshëm për reformimin e IP.

Ndërsa, lidhur me trajnimet për ngritjen e kapaciteteve të inspektorëve, ky aktivitet është pjesë e vazhdueshme e sistemit brenda institucionit. Gjatë vitit 2021 është zhvilluar trajnimi adekuat për adresimin e punës së padeklaruar. Dy trajnime janë organizuar me 5 koordinatorët rajonal të IP dhe zyrtarë tjerë të IP, ku është prezantuar manuali i ri për procedurat e inspektimit. Trajnime ka pasur edhe në fusha tjera specifike. Kurse, gjatë vitit 2022 është zhvilluar trajnimi për fushën e inspektimit në trajtimin e rasteve të punësimit të personave me aftësi të kufizuara. Në kuadër të trajnimeve, IP ka përgatitur Planin për Zhvillimin e Trajnimeve dhe ngritjen e kapaciteteve të inspektorëve të punës. Ky plan tani është vendosur në kuadër të Planit Zhvillimor të IP që pritet të miratohet së shpejti.

Sa i përket funksionalizimit/ndërtimit të Sistemit të Menaxhimit të Informatave, gjatë vitit 2022 IP ka vazhduar bashkëpunim me ILO (International Labour Organization) për konceptualizimin dhe zhvillimin e platformës elektronike për inspektime, menaxhim të informatave dhe CRM (Customer Relation Management). Aktiviteti mbështetet nga SIDA dhe pritet që të vazhdojë dhe të përmbyllet gjatë vitit 2023.


MFPT ka vazhduar me pajisjen e inspektorëve me mjete pune, ku gjatë periudhës 2022 janë blerë 20 kompjuterë për stafin e Inspektoriatit të Punës. Ndërsa, nuk ka pasur zhvillime lidhur me pajisjen e Inspektoriatit të Punës me vetura.

2.2 Progresi kundrejt Objektivit Strategjik II

Ky objektiv synon rritjen e burimeve financiare për shërbimet publike si rezultat i të hyrave shtesë tatimore dhe nga konfiskimi i pasurisë së paligjshme. Rrjedhojë direkte e ekonomisë joformale është pakësimi i të hyrave nga tatimet në buxhetin e Kosovës dhe ekzistenca e pasurive të paligjshme private. Të dyja këto pasoja ndikojnë në sasinë e burimeve të përdorura për shërbimet publike dhe po ashtu rrisin shkallën e pabarazisë dhe të padrejtësive që kanë ndikim negativ për stabilitetin dhe harmoninë e brendshme të shoqërisë Kosovare.

Objektivit Strategjik II përfshin gjithsej tetëmbëdhjetë (18) aktivitete, dymbëdhjetë (12) apo 67% prej të cilave janë zbatuar, kurse gjashtë (6) apo 33% prej tyre nuk janë zbatuar.

Grafiku 3. Zbatimi i aktiviteteve në kuadër të Objektivit Strategjik II për periudhën 2021-2022



Burimi: Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Jo-Formale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2019-2023

Objektivi specifik 2.1 synon përmirësimin sasior të të dhënave për të mundësuar zhvillimin e politikave që në mënyrë të efektshme kontribuojnë në uljen e ekonomisë joformale.

Ky objektivi specifik përmban gjithsej dy (2) aktivitete të cilat nuk janë zbatuar ende.

Lidhur me kryerjen e vlerësimeve të impaktit të masave të politikave të publikuara nga administrata e Kosovës me objektivi ekonominë joformale (Impact Assessments), për shkak të pandemisë por edhe mungesës së stafit e qarkullimit të madh të tij, MFPT nuk e ka zbatuar aktivitetin.

Poashtu, sa i përket kryerjes së studimeve apo vlerësimeve në fushën e ekonomisë joformale sipas standardeve ndërkombëtare lidhur me hendekun tatimor, MFPT në bashkëpunim me Bankën Botërore ka përgatitur vlerësimet preliminare të hendekut tatimor në Kosovë, duke u bazuar në Anketën e Buxhetit të Ekonomive Familjare të ASK-së për periudhën 2015-2017, përfshirë vlerësimin e TVSH-së dhe TAP-it. Në grupin punues përfshihen ATK dhe ASK. Të dhënat nuk janë publikuar ende.

Me **Objektivin specifik 2.2** është synuar rritja sasiore e përmbushjes vullnetare përmes ngritjes së vetëdijes, raportimit dhe masave ligjore të kufizimit.

Ky objektivi specifik përmban gjithsej dy (2) aktivitete, prej të cilave një (1) është zbatuar, kurse tjetra është e pazbatuar.

Lidhur me aktivitetin për uljen e pragut për transaksionet në mes të bizneseve të cilat bëhen në kesh (aktualisht 500 EUR), në draftligjin për Administrimin e Procedurave Tatimore është përfshirë dispozita e cila ulë pragun për transaksionet në mes të bizneseve të cilat bëhen në kesh nga 500 EUR në 100 EUR.

Sa i përket dizajnit të softuerit për arkat fiskale për të dhënë informata lidhur me numrin e kuponëve fiskal të lëshuar, kohën dhe artikujt në kohë reale (online), Konzorciumi përgjegjës (Interadria & Accent) për implementim të Sistemit të Menaxhimit të Pajisjeve Elektronike Fiskale në koordinim me ATK janë duke i përmirësuar dhe rregulluar problemet që janë vërejtur gjatë shfrytëzimit të këtij sistemi. Janë certifikuar 7 modele të Pajisjeve Elektronike Fiskale (4 Arka Fiskale, 2 Printera Fiskal dhe 1 Sistem Fiskal për Derivate) dhe numri i përgjithshëm i PEF të ri të instaluar gjatë vitit 2022 ka arritur në 4,686 pajisje.

Objektivi specifik 2.3 ka për qëllim përmirësimin sasior të kapaciteteve institucionale dhe bashkërendimit për zbatim më të mirë të politikave të miratuara.

Ky objektivi specifik ka gjithsej katërbëdhjetë (14) aktivitete, prej të cilave njëmbëdhjetë (11) apo 79% e tyre janë zbatuar, kurse tre (3) apo 21% nuk janë zbatuar.

Lidhur me rishikimin e formave standarde për shkëmbim të të dhënave elektronike dhe në bartës fizik me qëllim shkurtime të kohës së rrjedhës së informacionit në komunikimin ndërinstitucional dhe ndërkombëtar, në Platformën e Interoperabilitetit (PI-GG) janë integruar pothuajse të gjitha sistemet e rëndësishme të institucioneve, përmes të cilave mundësohet shkëmbimi i të dhënave në mënyrë të sigurtë, duke mundësuar ofrimin e shërbimeve më të mira për qytetarët, bizneset, OJQ-të, si dhe vet administratën e shtetit në nivelin qendror dhe atë lokal. Në këtë Platformë janë rreth 20 sisteme (Sistemet që japin të dhëna përmes GG), të cilat ofrojnë informacione të ndryshme për mbi 60 sisteme tjera (Sistemet që konsumojnë të dhëna përmes GG). Ndërsa, sa i përket shkëmbimit të të dhënave në nivel ndërkombëtar, vendi është në negociatë me vendet e rajonit pasi që asnjëra nga vendet nuk e kanë të zhvilluar këtë platformë ashtu siç kërkohet. MAP është në pritje të takimit i cili parashihet të mbahet në Estoni, ku do të dakordohet lidhur me zbatimin e sistemit, përkatësisht shkëmbimin e të dhënave në nivel ndërkombëtar.

Në anën tjetër, ASK është në proces të përpilimit të tabelave Ofruese/Përdoruese (Supply/Use Table) për vitet 2014-2016. Poashtu, në kuadër të projektit BE/SIDA këto tabela janë duke u përpiluar për vitin 2019. Të dhënat do të publikohen në TM4 2023.

Lidhur me përmirësimin e kapaciteteve të parashikimeve fiskale për të ardhurat nëpër sektorë përmes instalimit të moduleve të reja krahas modelit të programimit fiskal për shkak të lëvizjes së shpeshtë të stafit (sidomos gjatë vitit 2021 dhe 2022), në Divizionin e Makroekonomisë i cili mirret me parashikime makroekonomike, aktiviteti nuk u zbatua.

Sa i përket zgjerimit të inspektimeve në sektorin e ndërtimitarisë dhe OJQ-ve lidhur me FT (Financimi i Terrorizmit) dhe PP (Pastrimi i Parave), ku inspektimet tek subjektet e caktuara që paraqesin rrezik më të lartë të bazohen në inteligjencën financiare, tatimore dhe kriminale (Target të jetë sektori i ndërtimitarisë) gjatë vitit 2021, NJIF nuk ka realizuar inspektime në sektorin e ndërtimitarisë dhe OJQ-ve lidhur me FT/PP, megjithatë gjatë vitit 2022 janë zhvilluar 20 inspektime në sektorin e Noterisë. Kurse, ATK ka filluar projektin lidhur me zgjerimin e inspektimeve në sektorin e ndërtimit me rrezik lartë që nga

viti 2019. Gjatë vitit 2021, në sektorin e ndërtimit bazuar në analizën e rrezikut janë përfunduar 179 kontrole me tatim shtesë në vlerë prej 10,881,459 EUR dhe janë përfunduar 379 vizita. Kurse, gjatë vitit 2022 në sektorin e ndërtimit bazuar në analizë të rrezikut janë përfunduar 205 kontrole dhe 110 vizita.

Gjatë periudhës raportuese në mes të DK dhe ATK është funksionalizuar grupi i përbashkët DK-ATK për trajtimin e mallrave me rrezik të lartë të shmangies së taksave. Janë përcaktuar fushat me interes të përbashkët si dhe është hartuar plani i veprimit për ekipet e përbashkëta për luftimin e ekonomisë jo-formale për vitin 2023. Pëkatësisht, janë themeluar grupet punuese të cilat janë duke i koordinuar aktivitetet për trajtimin e sektorëve me rrezik të lartë, si tek mobishop, importet nga Kina dhe Turqia, importuesit e arit e stolive nga ari, importet e teknologjisë nga Kina, importet për vetura dhe lirimet nga lënda e parë.

Progres është arritur edhe në luftimin e kontrabandës së mallrave. Sipas Doganës së Kosovës gjatë vitit 2021 Njësitë Antikontrabandë ka realizuar 76 plane operative të përbashkëta me Agjencionet tjera të zbatimit të ligjit me qëllim të luftimit të kontrabandës së mallrave, ndërsa gjatë vitit 2022 ky njësit ka realizuar 92 plane operative apo 21% më tepër se në vitin paraprak. Në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, Njësitë Antikontrabandë në brendi të vendit, gjegjësisht në Zveçan, kanë zbuluar një laborator ilegal i cili përmbante rreth 10,000 bimë narkotike me vlerë rreth 6 milion EUR, ndërsa vlera e laboratorit të sekuestruar vlerësohet të jetë rreth 1.5 milion EUR. Gjithashtu, gjatë kontrolleve doganore në ngarkesa të ndryshme me mallra, zyrtarët doganorë në bashkëpunim me Policinë e Kosovës në dy raste kanë zbuluar 83.6 kilogram heroinë si dhe 70 kilogram narkotik të llojit captagon, të cilat më pas i janë dorëzuar Policisë së Kosovës për hetime të mëtejme.

Policia e Kosovës përkatësisht Departamenti i Hetimeve në koordinim me Policinë Kufitare gjatë vitit 2021 ka shkëmbyer 377 informata dhe ka realizuar tetë (8) hetime të përbashkëta, njëmbëdhjetë (11) operacione të përbashkëta dhe ka realizuar gjithsej katërmëdhjetë (14) takime operacionale të përbashkëta. Ndërsa, Policia Kufitare e cila merret kryesisht me Kontrabandimin e mallrave ka prezantuar se ka iniciuar 171 raste për veprën penale Kontrabandë me mallra, ka realizuar tridhjetë e pesë (35) Plane operative dhe ka organizuar njëzet (20) Operacione të përbashkëta me Institucionet tjera. Kurse, gjatë vitit 2022 në sferën e bashkëpunimit ndërinstitutional në koordinim me Policinë Kufitare ka shkëmbyer 395 informata dhe ka realizuar tetëmbëdhjetë (18) hetime të përbashkëta, tridhjetë e pesë (35) operacione të përbashkëta dhe gjithsej ka realizuar gjashtëdhjetë e tri (63) takime operacionale të përbashkëta. Ndërsa, Policia Kufitare e cila merret kryesisht me Kontrabandimin e mallrave ka prezantuar se ka iniciuar 140 raste për veprën penale Kontrabandë me mallra, ka realizuar njëzet (20) Plane operative dhe ka organizuar njëmbëdhjetë (11) Operacione të përbashkëta me Institucionet tjera.

Sa i përket aktivitetëve të ndërmarra për parandalimin e mallrave që shkelin të drejtën e pronësisë intelektuale, DK gjatë vitit 2022 ka iniciuar 612 raste për verifikim të mallrave që dyshohen se shkelin të drejtat e pronësisë intelektuale apo 72% më tepër se në vitin 2021. Janë ndaluar për verifikim 968,980 artikuj/mallra që dyshohet se shkelin të drejtat e pronësisë intelektuale. Janë konfiskuar mallra të falsifikuara në vlerë prej 8.7 milion EUR, si dhe janë asgjësuar 212,253 artikuj në vlerë prej 7.2 milion EUR.

Tabela 13. Aktivitetet e ndërmarrë për parandalimin e mallrave që shkelin të drejtën e pronësisë intelektuale gjatë periudhës 2021-2022

	2021	2022	Diferenca
Raste të verifikuara	355	612	72.39%
Artikuj të verifikuar	623,271	968,980	55.46%
Vlera e mallit të konfiskuar (EUR)	5,299,041	8,757,724	65.26%
Numri i artikujve të asgjësuar	80,931	212,253	162.26%
Vlera e mallit të asgjësuar (EUR)	3,351,423	7,271,912	116.97%

Burimi: Dogana e Kosovës

Lidhur me rritjen e numrit të patrullimeve të njësiteve anti kontrabandë me qëllim luftimin e kontrabandës, njësitë antikontrabandë në DK gjatë vitit 2022 kanë realizuar 1,571 patrullime, 3,017 ndalesa rrugore, 7,433 kontrole në Pikë Kalimet Kufitare, 167 plane operationale si dhe 92 plane operative të përbashkëta me agjencitë tjera të zbatimit të ligjit, me ç'rast kanë ngritur 282 kundërvajtje doganore për shmangie të detyrimeve doganore dhe kontrabandës me mallra në vlerë prej rreth 1.8 milion EUR.

Tabela 14. Statistikat lidhur me numrin e patrullimeve të njësiteve anti kontrabandë gjatë periudhës 2021-2022

	2021	2022	Diferenca
Patrullime	1,511	1,571	+4.00 %
Ndalesa rrugore	3,919	3,017	-23.01 %
Kontrolla në PKK	5,604	7,433	+ 32.63 %
Plane operative me Agjencione të tjera	76	92	+ 21.05 %
Kundërvajtje të zbuluara	298	282	-5.36 %
Vlera e mallit të zbuluar (EUR)	1,240,356	1,840,816	+ 48.41 %

Burimi: Dogana e Kosovës

Sa i përket aplikimit të kontrolleve pas importuese në bazë të menaxhimit të rrezikut dhe informacioneve tjera, DK në vitin 2022 ka zhvilluar 156 kontrolla pas importit të rregullta dhe pa paralajmërim. Janë lëshuar 100 aktvendime për inkasim të detyrimeve shtesë doganore në vlerë prej 4,7 milion EUR apo 39.7% më shumë se në vitin paraprak. Në fazën e inspektimit pas zhdoganimit janë inspektuar 39,461 deklarata doganore dhe janë rivlerësuar mallra në vlerë shtesë 375 mijë EUR. Është arritur të parandalohen mashtrimet në fushën e derivateve, gjegjësisht mashtrimet me lirimet nga taksat për derivate për qëllime të prodhimit si dhe mashtrimet me lirime në emër të përfaqësive diplomatike, ku efekti fiskal në parandalim vlerësohet të jetë mbi 5.6 milion EUR.

Në anën tjetër, gjatë vitit 2021 lidhur me trajnimet në fushën e menaxhimit të rrezikut, ATK ka pasur mbështetje nga ekspertët e FMN-së për parametrat e rrezikut në Departamentin e Tatimpagueseve të Mëdhenjë (DTM), për të cilat duhet të ketë kritere të tjera nga ato të përgjithshmet. Kurse, gjatë vitit 2022 ATK ka mbajtur trajnimet në vijim: “Managing Compliance Risks after the Covid -19 Pandemic”;

“Strengthening Tax Auditors Capability – Basic Skills”; “Tax Fraud in Digital Environment” dhe Kalkulimi i hendekut tatimor.

Ngjashëm, në fushën e zbatimit të ligjit, në vitin 2021 në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë janë mbajtur 23 trajnime të organizuara nga Dogana e Kosovës, ku janë trajnuar 92 oficerë doganorë. Ndërsa, gjatë vitit 2022 janë mbajtur 36 trajnime në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë si: EXBS (Export Control and Related Border Security Program), CEPOL (European Union Agency for Law Enforcement Training), WCO (World Customs Organization), UNDP (United Nations Development Programme), ku janë trajnuar 166 oficerë doganorë.

Sa i përket trajnimve për veprat penale kundër ekonomisë dhe pastrimit të parasë gjatë periudhës raportuese janë trajnuar gjithsej 64 prokurorë, si në tabelën në vijim.

Tabela 15. Trajnimet e prokurorëve për veprat penale kundër ekonomisë dhe pastrimit të parasë gjatë periudhës 2021-2022

Organizatori	Temat e trajnimit	Numri i pjesëmarrësve	
		2021	2022
Akademia e Drejtësisë	Program i Specializuar i Trajnimit Pastrimi i parave dhe hetimi financiar– Sesioni I	11	20
Akademia e Drejtësisë	Program i Specializuar i Trajnimit Pastrimi i parave dhe hetimi financiar– Sesioni II	5	5
Akademia e Drejtësisë	Program i Specializuar i Trajnimit Pastrimi i parave dhe hetimi financiar– Sesioni III	17	6

Gjatë periudhës raportuese edhe NJIF ka organizuar trajnime për institucionet që monitorojnë aktivitetet në sektorin e ndërtimtarisë mbi PP/FT, lidhur me parandalimin e ekonomisë joformale dhe krimet tjera financiare, posaçërisht në sektorin e ndërtimtarisë dhe patundshmërive (auditorët dhe inspektorët). Gjatë vitit 2021 janë mbajtur shtatë (7) aktivitete të trajnimeve me subjektet raportuese, si në vijim: Seminari me titull “Trajtimi i Personave të Ekspozuar Politikisht si klientë, identifikimi i klientëve dhe aktiviteteve të dyshimta dhe Tipologjitë e Pastrimit të Parave”; Punëtorja me temë “Vlerësimi i rrezikut Kombëtar për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit, Tipologjia dhe Rreziqet për PP/FT që ndërlidhen me Covid–19”; Webinari “Skemat e Pastrimit të Parave me Monedha Virtuale”; Konferenca online me titull “Vlerësimi i Riskut Kombëtar të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit të Kosovës”; Webinari “Prezantimi i Tipologjive të Financimit të Terrorizmit”; Forumi “Parandalimi i Pastrimit të Parave në Ekonomi dhe ndikimi i tyre”; Trajnimi/punëtorja me sektorin bankar dhe agjencionet e zbatimit të ligjit.

Kurse, gjatë vitit 2022, NJIF-K ka zhvilluar aktivitet e trajnimeve me sektorët financiarë dhe profesionet e lira. Si më të rëndësishmet ishin: Përforcimi i Partneritetit Publiko-Privat në parandalimin dhe luftimin e PPP/LFT; Punëtorja me sektorin e OJQ-ve; Trajnimi për BPCJF-të (Noter, Kontabilist, Auditor, Avokat, etj.); Punëtorja me sektorin financiar dhe BPCJ-të për pronësinë përfituese; Trajnimi me Noterët; Punëtorja për mbikqyrjen e bazuar në rrezik; Takime periodike me Shoqatën e Bankave; Punëtorja për

legjislacionin në fushën e PPP/LFT; Trajnimi me sektorin e OJQ-ve; Punëtorja për legjislacionin në fushën e PPP/LFT.

Lidhur me ngritjen e aftësive profesionale në fushën e PP/FT për Prokurorët, Gjyqtarët, Hetuesit dhe Inteligjencën Financiare, në vitin 2021 nga zyrtarët e NJIF-K janë ndjekur 26 trajnime, punëtori dhe seminare kurse, gjatë vitit 2022, NJIF-K ka marrë pjesë në mbi 40 aktivitete të trajnimeve profesionale në fushën e PPP/LFT. Zyrtarët e NJIF-K janë certifikuar nga ACAMS. Poashtu, PK ka realizuar një mori trajnimesh, ku pjesëmarrës kanë qenë në shumë raste Prokurorë, Gjyqtarë, Hetues nga Inteligjenca Financiare, etj. Trajnimet janë kategorizuar në Trajnime në nivel vendi dhe trajnime në nivel ndërkombëtar. Gjatë vitit 2021 brenda vendit janë mbajtur: 19 trajnime me 42 pjesëmarrës, 9 punëtori me 38 pjesëmarrës, 2 takime pune me 4 pjesëmarrës, 1 seminar me 14 pjesëmarrës dhe 2 webinarë me 7 pjesëmarrës. Kurse, jashtë vendit janë mbajtur: 6 trajnime me 13 pjesëmarrës, 1 punëtori me 1 pjesëmarrës dhe 3 takime pune me 3 pjesëmarrës. Ndërsa gjatë vitit 2022 brenda vendit janë realizuar 70 aktivitete, prej tyre: 58 trajnime, 8 punëtori, 1 seminar, 1 ligjëratë dhe 1 aktivitet me ushtrim praktik. Në lëmin e hetimeve financiare/PP/LF janë realizuar 10 aktivitete, në lëmin e hetimit të korrupsionit janë realizuar 5 aktivitete, në lëmin e ekonomisë janë realizuar 8 aktivitete dhe për tematika tjera në fushën e hetimeve janë realizuar 47 aktivitete. Kurse, jashtë vendit janë realizuar 31 aktivitete me 9 pjesëmarrës, prej tyre: 8 takime teknike dhe operacionale, 19 trajnime, 2 punëtori, 1 vizitë studimore dhe 1 seminar. Në lëmin e hetimeve financiare/PP/LF janë realizuar 8 aktivitete, në lëmin e hetimit të korrupsionit janë realizuar 6 aktivitete; në lëmin e ekonomisë janë realizuar 2 aktivitete dhe për tematika tjera në fushën e hetimeve janë realizuar 15 aktivitete.

3 Rreziqet dhe hapat e ardhshëm

3.1 Problemet dhe rreziqet

Situata pandemike në vend ka ndikuar që fillimi i zbatimit të Strategjisë Kombëtare të përballet me sfida të paparashikueshme. Me ndërmarrjen e masave për ta luftuar pandeminë është ndikuar edhe puna e institucioneve zbatuese dhe raportuese të Strategjisë Kombëtare. Si pasojë, një pjesë e aktiviteteve të planifikuara gjatë periudhës së pandemisë nuk janë realizuar sipas planit. Ndërsa, ngecja në progres gjatë periudhës raportuese vjen kryesisht si rezultat i vazhdimit të pengesave nga pandemia në realizimin e aktiviteteve, mungesës së stafit dhe qarkullimit të madh të stafit në departamente kyçe.

3.2 Hapat e ardhshëm

Pas tejkalimit të situatës me pandeminë sugjerohet që institucionet përgjegjëse ta rrisin bashkëpunimin ndërinstytucional, duke prioritetizuar aktivitetet e Strategjisë Kombëtare dhe realizimin e tyre sipas afateve të përcaktuara.

Lidhur me Objektivin Strategjik I, për t'i tejkaluar ngecjet e raportuara sugjerohet riplanifikimi i afateve të zbatimit të aktiviteteve nga institucionet përgjegjëse, përgatitja e infrastrukturës ligjore për zbatimin e aktiviteteve të Strategjisë Kombëtare, dokumentimi i proceseve të punës në departamente me qarkullim

të madh të punëtorëve dhe rritja e kapaciteteve të stafit përkatës për zbatimin e aktiviteteve të caktuara në Strategjinë Kombëtare.

Ngjashëm edhe me Objektivin Strategjik II sugjerohet riplanifikimi i afateve të zbatimit të aktiviteteve të ndikuara nga pandemia dhe dokumentimi i proceseve të punës tek departamentet me qarkullim të lartë të stafit.

Shtojca 1

Organogrami i mekanizmave mbikëqyrës dhe zbatues i Strategjisë Kombëtare

Strategjia Kombëtare identifikon institucionet e obliguara dhe përgjegjësitë e tyre në lidhje me hartimin, rishikimin, miratimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e Strategjisë dhe Planit të Veprimit. Mekanizmi për hartimin, rishikimin, miratimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e Strategjisë Kombëtare është paraqitur në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 4. Organogrami i mekanizmave mbikëqyrës dhe zbatues të Strategjisë Kombëtare

